



ZVOGËLIMI I RREZIKUT NGA FATKEQËSITË DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

UDHËZUES PËR INTEGRIMIN GJINOR



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNITED NATIONS
ALBANIA



ZVOGËLIMI I RREZIKUT NGA FATKEQËSITË DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

UDHËZUES PËR INTEGRIMIN GJINOR



UN WOMEN SHQIPËRI

2023

Ky publikim është përgatitur nga UN Women Shqipëri në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore në Shqipëri - Zbatimi i *acquis* të BE-së për Barazinë Gjinore” (EU4GE), që zbatohet nga UN Women dhe UNFPA dhe financohet nga Bashkimi Evropian përmes Fondit të Përsheptimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të autoreve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UN Women, Bashkimit Evropian, Kombeve të Bashkuara apo ndonjë prej organizatave të lidhura me to.

Autoret: Agustela Nini-Pavli, Ani Plaku, Katherine Belen, Dolly Wittberger

Përkthimi: Majlinda Nishku

Redaktimi: Majlinda Nishku, Monika Kocaqi

Faqosje dhe grafika: Erald Lamja

PASQYRA E LËNDËS

Shkurtesa dhe akronime	5
Hyrje	8
1. Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë dhe ndryshimet klimatike - çështjet gjinore kryesore në Shqipëri	13
2. Barazia gjinore në politikat për ndryshimet klimatike dhe ZRRF në kontekstin e anëtarësimit në BE	26
3. Lidhja e gjinisë në ndryshimet klimatike dhe ZRRF me <i>acquis</i> e BE-së për barazinë gjinore	29
3.1 Përafrimi me Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP) III të BE-së dhe treguesit përkatës	34
3.2 Instrumenti i Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA) III: integrimi gjinor sipas 'Rregulloreve të NDICI-t'	40
3.3 Vlerësuesi i politikave për barazinë gjinore i OECD-DAC	41
4. Metodatat dhe mjetet kryesore për integrimin gjinor	46
4.1 Analiza gjinore	47
4.2 Statistikat gjinore mbi ZRRF, mjedisin dhe ndryshimet klimatike në kontekstin shqiptar	48
4.3 Vlerësimi i ndikimit gjinor	51
4.4 Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor në kuadër të ndryshimeve klimatike dhe ZRRF	52
4.5 Prokurimi publik i përgjigjshëm gjinor	54
4.6 Monitorimi dhe vlerësimi i ndjeshëm gjinor	56
5. Rekomandime të rëndësishme për ZRRF dhe veprimet e lidhura me mjedisin dhe ndryshimet klimatike	58

LISTA E KUTIVE DHE TABELAVE

Kutia 1	Kuadri ligjor dhe i politikave përkatëse kryesore ndërkombëtare/globale	12
Kutia 2	Përmbledhje e çështjeve kryesore gjinore në ZRRF dhe ndryshimet klimatike në Shqipëri	25
Kutia 3	Diskriminimi gjinor i drejtpërdrejtë ose sistemik (i tërthortë)	25
Kutia 4	Shembuj të integritit gjinor në ZRRF	28
Tabela 1	Përafrimi i Kapitullit 27 me treguesit e GAP III të BE-së	36
Tabela 2	Kërkesat minimale për përmbushjen e kriterëve të Kategorisë 1 të vlerësuesit të politikave për barazinë gjinore të OECD-DAC	43
Tabela 3	Veprimet prioritare për integrimin e objektivave të barazisë gjinore në ZRRF dhe veprimet e lidhura me mjedisin dhe ndryshimet klimatike	59

SHKURTESA DHE AKRONIME

ABF	Anketa e Buxhetit të Familjes
AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
BE	Bashkimi Evropian
BPGJ	Buxhetim i Përgjigjshëm Gjinator
BPfA	Platforma për Veprim e Pekinit
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
COP	Konferenca e Palëve
COVID-19	Sindroma e rëndë akute e rrugëve të frymëmarrjes shkaktuar nga koronavirusi 2 (SARS-CoV-2)
DAP	Departamenti i Administratës Publike
EIGE	Instituti Evropian për Barazinë Gjinore
EU4GE	BE për Barazinë Gjinore
FAO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë
GAP	Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (i BE-së)
GEF	Fondi Global i Mjedisit
GIZ	Korporata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
GPF	Gatishmëria për Përballimin e Fatkeqësive
ILO	Organizata Botërore e Punës
INSTAT	Instituti i Statistikave i Shqipërisë
IPA	Instrumenti i Asistencës së Para – Anëtarësimit
IUCN	Bashkimi Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës
KE	Komisioni Evropian
KK4	Komunikimi i Katërt Kombëtar
KP	Komuniteti i Paqësorit
KS ZRRF	Korniza Sendai për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë
LBGJ	Ligji për Barazinë Gjinore
MRRF	Menaxhimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë
M&V	Monitorimi dhe Vlerësimi
NDICI	Instrumenti i Fqinjësisë, Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar

OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OECD-DAC	Komiteti i Asistencës për Zhvillim i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OMZHG	Organizata e Mjedisit dhe Zhvillimit të Gruas
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
OZHQ	Objektiv i Zhvillimit të Qëndrueshëm
PBA	Program Buxhetor Afatmesëm
PKSPNK	Plani Kombëtar i Spanjës për Përshtatjen me Ndryshimet Klimatike
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
PKVZ	Plani Kombëtar i Veprimit i Zbutjes (së ndryshimeve klimatike)
PPBGJL	Programi i Punës për Barazinë Gjinore i Limës
PPPGJ	Prokurim Publik i Përgjigjshëm Gjinator
PTVM	Programi i Tetë i Veprimit për Mjedisin
PVM	Programi i Veprimit për Mjedisin
QNT- ILO	Qendra Ndërkombëtare e Trajnimit e ILO-s
SANECA	Mbështetje për Negociatat e Anëtarësimit të Shqipërisë për Kapitujt Ekonomikë të Acquis
SAKJ	Statistikat për të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës (e BE-së)
SDSH	Studimi Demografik dhe Shëndetësor
SKBGJ	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
SKNK	Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike
TBE	Traktat i Bashkimit Evropian
TFBE	Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian
UN	Kombet e Bashkuara
UN ECOSOC	Këshilli Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara
UN ESCAP	Komisioni Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara për shtetet e Azisë dhe të Paqësorit
UN Women	Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

UNDRR	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë
UNECE	Komisioni Ekonomik për Evropën i Kombeve të Bashkuara
UNEP	Programi i Mjedisit i Kombeve të Bashkuara
UNFCCC	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin
USD	Dollari i Shteteve të Bashkuara
VGTSH	Vrojtimi i Grupeve me Tregues të Shumëfishtë
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VNPF	Vlerësimi i Nevojave pas Fatkeqësive
ZRRF	Zvogëlimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë

HYRJE

Ky Udhëzues për integrimin gjinor është pjesë e një vargu materialesh burimore që i janë vënë në dispozicion qeverisë së Shqipërisë përmes ndihmës teknike të BE-së dhe UN Women, me qëllim përshpejtimin e procesit të integritit në BE. Qëllimi i tij është të sigurojë që dokumentet e ardhshme të politikave, planifikimit dhe programimit të përafrohen ngushtë me kuadrin ligjor dhe të politikave të BE-së për barazinë gjinore (“*acquis* për barazinë gjinore”), çka do të sjellë përmirësimin e rezultateve të barazisë për të gjitha/gjithë: gratë, burrat, vajzat dhe djemtë në mbarë vendin. Ai u drejtohet partnerëve të zhvillimit dhe integritit të përfshirë në nisma të politikave, programimit dhe planifikimit, në kontekstin e anëtarësimit në BE. Në këtë grup përfshihen së pari nëpunëset/nëpunësit që formulojnë politikat dhe hartojnë programet e IPA-s, ekspertet/ekspertët që ofrojnë ndihmë teknike, drejtueset/drejtuesit e projekteve pranë Delegacionit të BE-së, donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë të zhvillimit që mbështesin reformën e përafritit me BE-në dhe organizatat e shoqërisë civile (OSHC) të angazhuara në proceset e llogaridhënies dhe konsultimit. Qëllimi i këtij udhëzuesi është që të ofrojë informacion të përmbledhur mbi çështjet gjinore kryesore në një fushë të caktuar të politikave dhe të tregojë se si mund të realizohet integrimi gjinor në terma praktikë. Udhëzuesi është parashikuar si një material përgatitor për hedhjen e bazave në këtë drejtim. Ai mund të përdoret nga individët si dokument orientues në punën e tyre të përditshme dhe shërben si material trajnimi në përpjekjet për të krijuar kapacitete dhe aftësi për integrimin gjinor.

Barazia ndërmjet grave dhe burrave është një parim themelor i Bashkimit Evropian. E drejta e grave për trajtim të barabartë është, para së gjithash, një nga të drejtat themelore të njeriut. Legjislacioni i BE-së, e njeh diskriminimin si të papranueshëm politikisht, pa përfitim ekonomik, dhe të dënueshëm me ligj. Për këtë arsye, shteteve u kërkohet që të përmbushin kërkesat e *acquis* për barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE. Siç përcaktohet në legjislacionin e BE-së, strategjia për promovimin e barazisë ndërmjet grave dhe burrave dhe luftimin e diskriminimit është integrimi gjinor. Rrjedhimisht, integrimi gjinor është parakusht për përafritimin e standardeve kombëtare me parimet e BE-së dhe një element i pandashëm i proceseve vijuese të reformës.

Gratë dhe vajzat ndikohen në mënyrë disproporcionale nga fatkeqësitë dhe kërcënimet, duke përfshirë edhe ndryshimet klimatike. Shumë shpesh, kur diskutohen dhe trajtohen çështjet e zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë (ZRRF) dhe ndryshimet klimatike, aspektet gjinore nuk merren parasysh dhe, për pasojë, jo rrallë nevojat dhe kapacitetet specifike të grave dhe vajzave neglizhohen. Rreziqet me të cilat përballen gratë mund të rëndohen më tej

si pasojë e formave të ndryshme të pabarazive që ndërthuren dhe ndikojnë mbi njëra-tjetrën, si për shembull pabarazitë për arsye të moshës, aftësive të kufizuara, përkatësisë etnike, klasës shoqërore, statusit të emigrimit/imigrimit, seksualitetit, etj. Kjo thekson nevojën për kryerjen e një analize gjinore të shumanshme dhe shumëdimensionale që të shërbejë si bazë për programet e ZRRF-së dhe të ndryshimeve klimatike, që u përgjigjen nevojave dhe cënueshmërive specifike me të cilat përballen individët.¹

Lidhjet ndërmjet gjinisë, mjedisit dhe ndryshimeve klimatike janë studiuar gjerësisht dhe ndërthurja e tyre bëhet e qartë në instrumentet ndërkombëtare që janë nënshkruar nga Komisioni Evropian, ose në të cilat ai është palë. **Korniza Sendai për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2015-2030** (KS ZRRF) është një politikë globale për zvogëlimin e rrezikut dhe ndërtimin e forcimit të aftësive ripërtëritëse të shteteve. Ajo njeh rëndësinë e integritetit të një perspektive gjinore në të gjitha politikat dhe praktikën e ZRRF-së, si dhe nevojën për të fuqizuar gratë, që ato të vihen publikisht në role drejtuese dhe udhëheqëse të përgjigjes për rimëkëmbjen, rehabilitimin dhe rindërtimin, të cilat duhet të jenë të barabarta nga pikëpamja gjinore dhe të aksesueshme universalisht.²

Në nivel global, mekanizmi kryesor i llogaridhënies për klimën është procesi ndërqeveritar i Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), i cili përcakton synimet ndërkombëtare që do të ndiqen kolektivisht nga të gjitha 198 palët në konventë dhe shqyrton rregullisht pajtueshmërinë e shteteve me to, përmes mekanizmave kombëtarë të raportimit. Palët nënshkruese të **Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike** (UNFCCC) kanë pranuar rëndësinë që ka përfshirja e barabartë e grave dhe burrave në proceset e UNFCCC-së përmes **Programit të Punës për Barazinë Gjinore të Limës** (PPBGJL) në vitin 2018 dhe programit të përparuar pesëvjeçar të punës të Limës mbi barazinë gjinore dhe planin e tij të veprimit, që u miratuan në vitin 2019.^{3,4} Që atëherë, gjuha e lidhur me gjininë

1 Zyra e Kombeve të Bashkuara për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë, *Gender* (Gjinia) (2022). Shih: <https://www.undrr.org/gender>

2 Korniza Sendai për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2015-2030. Gjendet (në gjuhën angleze) në: <https://www.undrr.org/implementing-sendai-framework/what-sendai-framework>

3 UNFCCC (2014). *Lima Work Programme on Gender (LWPG)*. (Programi i Punës për Barazinë Gjinore të Limës – PPBGJL), *Decision* (Vendimi) 18/CP.20. Shih: <https://unfccc.int/topics/gender/workstreams/the-gender-action-plan>

4 UNFCCC (2020). *Enhanced Lima work programme on gender and its gender action plan*, *Decision* 3/CP.25. (Programi i punës i zgjeruar i Lima-s për barazinë gjinore dhe planin e tij të veprimit, Vendimi 3/CP.25). Shih: <https://unfccc.int/topics/gender/workstreams/the-enhanced-lima-work-programme-on-gender>

u përfshi në të paktën 120 vendime të UNFCCC dhe përfaqësimi i grave në negociatat globale për klimën u rrit.⁵

Aspektet e gjinisë dhe të ndryshimeve klimatike u forcuan në dispozitat e përgjithshme të **Marrëveshjes së Parisit**, e cila promovon zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe veprimeve të përgjigjshme gjinore të efektshme në nivel rajonal, kombëtar dhe vendor.⁶ Gjithashtu, **Konventa e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave** (UN CEDAW) kërkon që të gjitha politikat, ligjet, planet, programet, buxhetet dhe veprimtaritë e tjera që lidhen me zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe ndryshimet klimatike të jenë të përgjigjshme gjinore, të synojnë zvogëlimin e diskriminimit dhe të rritin barazinë.⁷

I strukturuar në pesë pjesë të shkurtra, Udhëzuesi për Integrimin Gjinor në Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë dhe Ndryshimet Klimatike synon të mbështesë aktorët e interesuar që:

- të kuptojnë problemet e pabarazisë gjinore që lidhen me ZRRF-në dhe ndryshimet klimatike;
- të njohin kuadrin ligjor ndërkombëtar përkatës dhe rekomandimet e politikave dhe direktivat e BE-së;
- të identifikojnë treguesit përkatës për integrimin gjinor në këtë fushë të politikave;
- të njohin metodat dhe mjetet e standardizuara të BE-së për përfshirjen e objektivave të barazisë gjinore;
- të angazhohen në veprimtari të mëtejshme konkrete, bazuar në një listë të përmbledhur rekomandimesh kryesore.

5 Në Konferencën e Palëve 27 në vitin 2022, gratë përbënin 35 për qind të delegacioneve të Palëve. Shih: Organizata e Mjedisit dhe Zhvillimit të Gruas OMZHG (2023). Gjurmuesi gjinor i klimës. Cjendet (në gjuhën angleze) në: <https://genderclimatetracker.org>

6 Marrëveshja e Parisit për Klimën (2015). Shih: <https://unfccc.int/process-and-meetings/the-paris-agreement/the-paris-agreement>

7 Komiteti i UN CEDAW (2018). *General Recommendation No. 37 on Gender-related dimensions of disaster risk reduction in the context of climate change*. (Rekomandimi i përgjithshëm nr. 37 mbi përmasat gjinore të zvogëlimin të rrezikut nga fatkeqësitë në kontekstin e ndryshimeve klimatike). Shih: <https://reliefweb.int/report/world/general-recommendation-no-37-gender-related-dimensions-disaster-risk-reduction-context#:~:text=The%20general%20recommendation%20focuses%20on,and%20fulfilled%20in%20accordance%20with>

“Kapacitetet e grave dhe vajzave për të ndërmarrë veprime dhe për të krijuar dhe zhvilluar aftësitë ripërtëritëse varen nga ngushtimi i dallimeve gjinore, eliminimi i barrierave strukturore ekzistuese, normave shoqërore negative dhe stereotipeve gjinore, nga përmirësimi i aksesit të grave në arsim, në njohuri, mbrojtje sociale universale, financa, teknologji, lëvizshmëri dhe në asete të tjera, si dhe nga pronësia dhe kontrolli i tyre mbi tokën dhe forma të tjera të pronësisë, trashëgimisë, burimeve natyrore, teknologjive të reja dhe shërbimeve financiare të përshtatshme, përfshirë mikrofinancimin.

Pjesëmarrja dhe pozicioni udhëheqës i plotë, efektiv dhe domethënës i grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes është me rëndësi kritike për rritjen e efektshmërisë së veprimeve në përgjigje të ndryshimeve klimatike dhe mjedisore, si dhe të përpjekjeve për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe atyre të rimëkëmbjes.”

Burimi: Përfundimet e miratuara të Sesionit të 66-të të Komisionit të Kombeve të Bashkuara mbi Statusin e Grave, 14-25 mars 2022, gjendet në: <https://digitallibrary.un.org/record/3970226?ln=en>

Barazia gjinore nuk ka të bëjë vetëm me ‘gratë’.

Përkundrazi, ajo ka të bëjë me realitetet dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave në të gjithë shoqërinë; dhe me pranimin që këto realitete dhe nevoja duhet të vlerësohen dhe – çka është e rëndësishme – të edukohen.

Për këtë është e nevojshme të sigurohet që të gjithë njerëzit të fuqizohen që të luajnë një rol të plotë dhe produktiv në familje, komunitet, shoqëri dhe ekonomi. Të jenë vetë zot të jetës së tyre, të bëjnë zgjedhjet që dëshirojnë dhe, për rrjedhojë, të kenë akses të drejtë dhe të barabartë në shërbime, mbështetje dhe në mundësi.

Prandaj, qeverisja e përgjigjshme gjinore ka të bëjë me sigurimin që, në të gjitha politikat, programet, aktivitetet, përparësitë dhe buxhetet e përgatitura prej saj, qeveria mban parasysh nevojat dhe shqetësimet e ndryshme të grave dhe burrave, si dhe trajton dhe redukton pabarazitë ndërmjet tyre.

Integrimi gjinor është procesi i përfshirjes së perspektivës gjinore që në fazat e hershme të planifikimit e deri në vendimet përfundimtare mbi zhvillimin dhe zbatimin e politikave në një fushë të caktuar. Kjo qasje bën të mundur që politikat dhe programet të vlerësohen nga këndvështrimet e grave dhe burrave, si dhe të personave me identitete të shumëllojshme gjinore, në mënyrë që nga vendimet e marra të përfitojë popullsia në tërësi. Në këtë mënyrë, integrimi gjinor është metodë kryesore për arritjen e barazisë gjinore.

KUTIA 1

Kuadri ligjor dhe i politikave përkatëse kryesore ndërkombëtare/globale

Korniza Sendai për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2015-2030

“Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë kërkon angazhim dhe partneritet në kuadër të mbarë shoqërisë. Ai kërkon gjithashtu fuqizim dhe pjesëmarrje përfshirëse, të aksesueshme dhe jodiskriminuese, dhe u kushton vëmendje të posaçme personave që ndikohen në mënyrë disproporcionale nga fatkeqësitë, në veçanti më të varfërve/ varfërve. Në të gjitha politikat dhe praktikat duhet të integrohen perspektivat gjinore, të moshës, të aftësisë së kufizuar dhe kulturore, si dhe duhet të nxitet roli drejtues i grave dhe i rinisë. Në këtë kontekst, vëmendje e posaçme duhet t’i kushtohet përmirësimit të punës vullnetare të organizuar të qytetareve/ qytetarëve.”

Marrëveshja e Parisit për Ndryshimet Klimatike

“Duke pranuar se ndryshimet klimatike janë shqetësim i përbashkët i të gjithë njerëzimit, Palët, kur të ndërmarrin veprime për t’iu përgjigjur ndryshimeve klimatike, duhet të respektojnë, promovojnë dhe marrin parasysh detyrimet e tyre përkatëse lidhur me të drejtat e njeriut, të drejtën për jetë të shëndetshme, të drejtat e popullatave indigjene, komuniteteve vendore, emigranteve/ emigrantëve, imigranteve/imigrantëve, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara dhe personave në situata të pafavorizuara, të drejtën për zhvillim, si dhe barazinë gjinore, fuqizimin e grave dhe trajtimin me drejtësi të brezave.”

Rekomandimi i përgjithshëm nr. 37 i Komitetit të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave mbi përmasat gjinore të zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë në kontekstin e ndryshimeve klimatike

“Shtetet palë duhet të sigurojnë që të gjitha politikat, ligjet, planet, programet, buxhetet dhe veprimtaritë e tjera që lidhen me zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe ndryshimet klimatike të jenë të përgjigjshme gjinore dhe të mbështeten në parimet e të drejtave të njeriut, ndër të cilat:

- (a) Parimet e barazisë dhe të mosdiskriminimit, duke u dhënë përparësi grupeve më të marginalizuara të grave dhe vajzave, siç janë ato nga grupet e pakicave indigjene, racore, etnike dhe seksuale, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, adoleshentet, gratë e moshuara, gratë beqare, gratë kryefamiljare, gratë e veja, gratë dhe vajzat që jetojnë në varfëri si në zonat rurale ashtu edhe në ato urbane, gratë e përfshira në prostitucion dhe gratë e zhvendosura brenda vendit, pa shtetësi, gratë refugjate, azil-kërkuese dhe emigrante/imigrante;
- (b) Parimet e pjesëmarrjes dhe fuqizimit, përmes miratimit të proceseve të efektshme dhe caktimit të burimeve të nevojshme për të siguruar që grupe të ndryshme të grave të kenë mundësi të marrin pjesë në të gjitha fazat e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave, në të gjitha nivelet e qeverisjes, që nga niveli vendor deri në atë kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;
- (c) Parimet e llogaridhënies dhe aksesit në drejtësi, që kërkojnë sigurimin dhe dhënie të informacionit të përshtatshëm dhe të saktë, si dhe të mekanizmave për të bërë të mundur që të gjitha gratë dhe vajzat të drejtat e të cilave janë ndikuar drejtpërdrejt ose tërthorazi nga fatkeqësitë dhe ndryshimet klimatike, të përfitojnë nga mjete juridike dhe masa të përshtatshme dhe të marra në kohën e duhur.”

1 ZVOGËLIMI I RREZIKUT NGA FATKEQËSITË DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE - ÇËSHTJET GJINORE KRYESORE NË SHQIPËRI

Çështjet që trajtohen në këtë udhëzues janë të ndërlikuara dhe të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Për ta bërë udhëzuesin më praktik, vëmendja kryesore do të përqendrohet në dy tema të gjera: Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë (ZRRF) dhe ndryshimet klimatike.

'Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë' i referohet objektivit të politikave që synojnë parashikimin dhe zvogëlimin e rrezikut. Nocioni i menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë (MRRF) shpesh përdoret në mënyrë të ndërsjellë me ZRRF-në dhe mund të konsiderohet si zbatim i ZRRF-së, duke qenë se në të përkrahjen veprimet që synojnë arritjen e objektivit të zvogëlimin të rrezikut. Në të shkuarën, trajtimi dhe përballimi i fatkeqësive fokusohet në reagimin ndaj emergjencave, por nga fundi i shekullit të njëzetë filloi të pranohet gjithnjë e më shumë se fatkeqësitë nuk janë natyrore (edhe në qoftë se rreziku që lidhet me to mund të jetë natyror) dhe se vetëm duke zvogëluar dhe menaxhuar kushtet e rrezikut, ekspozimit, dhe cenueshmërisë, mund të parandalohen humbjet dhe të zbutet ndikimi i fatkeqësive. Duke qenë se njerëzit nuk mund të zvogëlojnë shkallën e ashpërsisë apo madhësisë së rreziqeve natyrore, **mundësia kryesore për zvogëlimin e rrezikut qëndron në zvogëlimin e cenueshmërisë dhe të ekspozimit ndaj atij rreziku.** Për të zvogëluar këta dy përbërës të rrezikut, duhet të identifikohen dhe zvogëlohen faktorët bazë që **bëhen shkas për vënien në rrezik**, që lidhen në veçanti me

- zgjedhjet dhe praktikat e dobëta të zhvillimit ekonomik dhe urban,
- degradimin e mjedisit,
- varfërinë dhe pabarazinë, dhe
- ndryshimet klimatike.

Trajtimi i këtyre faktorëve shkaktues të rrezikut zvogëlon rrezikun nga fatkeqësitë, pakëson ndikimin e ndryshimeve klimatike dhe, rrjedhimisht, bën të mundur një zhvillim të qëndrueshëm.

Burimi: Zyra e Kombeve të Bashkuara për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë, Rrjeti i Parandalimit (2022), *Understanding Disaster Risk*, (Kuptimi i rrezikut nga fatkeqësitë), gjendet (në gjuhën angleze) në: <https://www.preventionweb.net/understanding-disaster-risk/key-concepts/disaster-risk-reduction-disaster-risk-management>

'Ndryshimet klimatike' u referohen ndryshimeve të klimës që shkaktohen drejtpërsëdrejti ose tërthorazi nga veprimtaritë njerëzore që ndryshojnë përbërjen e atmosferës globale dhe ndodhin krahas ndryshueshmërisë klimatike natyrore që vërehet gjatë periudhave të krahasueshme kohore. 'Ndikimet negative të ndryshimeve klimatike' janë ndryshimet në mjedisin fizik ose në organizmat e gjalla që janë pasojë e ndryshimeve klimatike dhe kanë ndikim të konsiderueshëm dëmtes mbi përbërjen, aftësinë ripërtëritëse, ose produktivitetin e ekosistemeve natyrore dhe të menaxhuara, ose mbi funksionimin e sistemeve socio-ekonomike, shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve.

Burimi: *United Nations Framework Convention on Climate Change, Article 1*. (Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike, Neni 1), shih: https://unfccc.int/files/essential_background/background_publications_htmlpdf/application/pdf/conveng.pdf

Fatkeqësitë shkaktojnë probleme dhe pengesa të mëdha në funksionimin e komuniteteve apo shoqërive në çfarëdo niveli, si pasojë e ngjarjeve të rrezikshme që ndërveprojnë me kushtet e ekspozimit të njerëzve, cenueshmërisë dhe kapaciteteve. Këto mund të çojnë në humbje dhe ndikime negative materiale, ekonomike dhe mjedisore.⁸ Nga ana tjetër, ndryshimet klimatike janë një prej faktorëve kryesorë shkaktues të krizave në planetin tonë (krahas humbjes së biodiversitetit, ndotjes dhe mbetjeve).⁹ Ndryshimet klimatike dhe ngjarjet meteorologjike gjithnjë e më të skajshme kanë shkaktuar rritje të madhe në numrin e fatkeqësive natyrore në 50 vitet e fundit. Që nga viti 1970 deri në 2019, rreziqet natyrore përbënin 50 për qind të të gjitha fatkeqësive, shkaktuan 45 për qind të numrit të përgjithshëm të vdekjeve të raportuara dhe 74 për qind të humbjeve të përgjithshme ekonomike. Në nivel global, më se 11,000 fatkeqësi të raportuara u atribuohen këtyre rreziqeve, me pak më shumë se dy milion vdekje dhe 3,64 trilion USD humbje ekonomike. Më se 91 për qind e vdekjeve kanë ndodhur në vendet më pak të zhvilluara.¹⁰

Menaxhimi i rrezikut nga fatkeqësitë është kusht i domosdoshëm për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Analizat tregojnë se edhe në Shqipëri ka pasur rritje në numrin e ngjarjeve të fatkeqësive gjatë tridhjetë viteve të fundit, të tilla si përmbytje, zjarre në pyje, rrëshqitje të tokës, stuhi, stuhi dëbore, dhe reshje të forta shiu. Bashkitë më të prekura janë Fieri, Vlora, Gjirokastra, Përmeti, dhe Mallakastra.¹¹

Gratë dhe vajzat ndikohen në mënyrë disproporcionale nga fatkeqësitë dhe kërcënimet e shkaktuara prej ndryshimeve klimatike. Si rezultat i barrierave dhe pabarazive specifike gjinore, numri i humbjeve të jetës dhe humbjeve të mjeteve të jetesës gjatë fatkeqësive është më i madh tek gratë dhe atyre u duhet më shumë kohë të rimëkëmben. Në të gjitha fushat dhe aspektet – që nga jetëgjatësia tek arsimi, strehimi, shëndetësia, siguria, siguria në punë, dhe ushqyerja, ndikimi tek gratë dhe vajzat është më i madh se sa tek burrat. E megjithatë, gratë janë përgjithësisht të përjashtuara nga marrja e vendimeve për

8 Zyra e Kombeve të Bashkuara për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë (2022). Shih: <https://www.undrr.org/terminology/disaster>

9 Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (2022). Shih: <https://www.unep.org/about-un-environment>

10 Organizata Botërore Meteorologjike (2021). *State of Climate in 2021: Extreme events and major impacts* (Gjendja e klimës në vitin 2021: Ngjarje të skajshme dhe ndikime madhore); *UN News 2021*. Climate and weather-related disasters surge five-fold over 50 years, but early warnings save lives. (Lajme të Kombeve të Bashkuara 2021. Fatkeqësitë e klimës dhe motit rriten pesëfish gjatë 50 viteve, por paralajmërimet e hershme shpëtojnë jetë). Shih: <https://news.un.org/en/story/2021/09/1098662>

11 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, GEF dhe UNDP (2021). Raporti i parë dyvjeçar i përditësuar për Shqipërinë për Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) 2021. Shih: <https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/Botimi-i-pare-shqip.pdf>

zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe nga vendimmarrja lidhur me politikën, strategjitë dhe programet për aftësitë ripërtëritëse.¹² Kjo është e vërtetë edhe për gratë në Shqipëri, të cilat vitet e fundit kanë pasur shumë pasoja si rezultat i disa fatkeqësive, përfshirë edhe ato të shkaktuara nga ndryshimet klimatike.

Gratë përballen me më shumë pasoja të drejtpërdrejta të fatkeqësive

Gjatë viteve të fundit Shqipëria është goditur nga disa fatkeqësi me pasoja të mëdha njerëzore dhe financiare, ndër të cilat përmbytje të përsëritura (2015, 2017, 2020-21 dhe 2022), tërmeti i vitit 2019, pandemia e Covid-19, si dhe zjarre. Gjatë pranverës së vitit 2021, në veri të vendit (Shkodër dhe Lezhë) u përmbytën mijëra hektarë tokë, ndërsa kohët e fundit (vjeshtë-dimër 2021-2022) u përmbytën 1200 hektarë tokë në jug, me pasojë të drejtpërdrejtë reduktimin e prodhimit bujqësor dhe varfërimin e grave dhe burrave të prekur prej tyre. Tokat në Kutalli – një prej zonave më prodhimtare në vend, e njohur për prodhimin e perimeve në serra – janë përmbytur tri herë gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, ndërsa thatësira ka shkatërruar të mbjellat më shumë se pesë herë. Periudha më problematike për sa i përket fatkeqësive nga përmbytjet është ajo nga tetori në mars, periudhë në të cilën në lumenj dhe dete shkarkohen sasi maksimale reshesh. Më se 98 për qind e të gjitha ngjarjeve, përfshirë zjarret në pyje, shkaktohen nga kushtet meteorologjike.¹³

Në Shqipëri mungojnë studime gjithëpërfshirëse mbi ndikimin e këtyre ngjarjeve mbi gratë dhe burrat. Megjithatë, një numër raportesh tregojnë se gratë – sidomos ato që kishin qenë edhe më parë në situatë të cënueshme – u ndikuan më rëndë nga pasojat e rreziqeve natyrore dhe kriza shëndetësore. Për shembull, pas përmbytjeve të vitit 2015 në juglindje të vendit, UN Women dokumentoi një numër pasojash të përmbytjeve tek gratë, si shtimi i ngarkesës së punës me mesatarisht katër orë si rrjedhojë e pastrimit dhe mungesës së furnizimit me energji; rritja e dhunës ndaj grave si brenda ashtu edhe jashtë familjes, ku gratë kryefamiljare ishin më të rrezikuara; pakësimi i të ardhurave; humbja e tokës së punueshme bujqësore dhe e bagëtive; dhe humbja e aksesit në shërbime që lehtësojnë ngarkesën e punës së grave (p.sh. në kopshte, shkolla, etj.).¹⁴

12 UN Women (2022). *Disaster Risk Reduction*. (Zvogëlimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë). Shih: <https://www.unwomen.org/en/what-we-do/humanitarian-action/disaster-risk-reduction>

13 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, GEF dhe UNDP (2021). Raporti i parë dyvjeçar i përditësuar për Shqipërinë për Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike (UNFCCC). Shih: <https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/Botimi-i-pare-shqip.pdf>

14 *Po aty*.

Vlerësimi i nevojave pas fatkeqësive (VNPF) që u krye pas tërmetit të vitit 2019 për vlerësimin e performancës së shërbimeve të ZRRF-së, konstatoi se “... përgjigjja [ndaj tërmetit] u ndikua nga një varg kushtesh ekzistuese të pafavorshme [...]”. Në veçanti, VNPF-ja vuri në pah ndikimin disproporcional të tërmetit tek gratë dhe vajzat në zonat e prekura dhe gjasat e rritjes së ngarkesës së tyre me punë, sidomos për gratë që jetojnë me familjet e tyre. Kjo për shkak se gjasat janë që gratë të shtyhen më tej drejt roleve dhe veprimtarive të tyre tradicionale, si kujdesi për fëmijët dhe për anëtarët/anëtarët e moshuara/moshuar apo të sëmura/sëmurë të familjes, pastrimi, si dhe kujdesi për atë çka ka mbetur prej banesave të tyre.¹⁵ Organizatat e shoqërisë civile që punojnë në komunitetet e prekura nga tërmeti raportojnë se të drejtat pronësore të grave në këto zona mund të rrezikohen më tej sepse shumë shtëpi dhe apartamente që po u dhurohen familjeve të prekura ka të ngjarë të regjistrohen vetëm në emër të kryefamiljarëve - tradicionalisht burra - ndonëse sipas legjislacionit mbi pronësinë, pronat e përfuara gjatë martesës duhet të regjistrohen në emër të të dy bashkëshortëve.¹⁶

Një vlerësim i shpejtë gjinor që u krye pas shpërthimit të pandemisë Covid-19 në Shqipëri tregoi se gratë u përballën me shumë më tepër kufizime se burrat për sa i përket aksesit në ushqime (46 për qind kundrejt 43 për qind), për shkak të mbylljes së tregjeve dhe reduktimit të orëve të punës nëpër dyqane. Më shumë gra (51 për qind) se sa burra (27 për qind) punuan nga shtëpia dhe jo nga vendi i zakonshëm i punës. Si pasojë e tronditjes së sigurisë ekonomike të grave, ngarkesa e tyre me punë të papaguar dhe punë shtëpie u rrit: 76 për qind e grave raportuan se shpenzonin më shumë kohë duke kryer punë shtëpie, krahasuar me 66 për qind të burrave. Përveç kësaj, ndikimi ishte më i madh edhe në shëndetin psikologjik dhe mendor të grave (69 për qind e grave kundrejt 57,5 për qind të burrave) dhe gratë kishin më shumë vështirësi në kërkimin e ndihmës mjekësore se sa burrat (55 për qind e grave kundrejt 45 për qind të burrave).¹⁷

15 Kombet e Bashkuara, Shqipëri (2020). *Albania Post Disaster Need Assessment* (Vlerësimi i nevojave pas fatkeqësive në Shqipëri). <https://albania.un.org/en/46378-albania-post-disaster-needs-assessment-pdna-volume-report-february-2020>

16 *UN Country Team Albania Report to CEDAW* (Raporti i Ekipit të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri për CEDAW), 2022 (i pabotuar).

17 UN Women (2020). *The impact of COVID-19 on women's and men's lives and livelihoods in Europe and Central Asia: Preliminary results from a Rapid Gender Assessment*. (Ndikimi i Covid-19 në jetën dhe mjetet e jetesës së grave dhe burrave në Evropë dhe Azinë Qendrore: Rezultatet paraprake të një vlerësimi të shpejtë gjinor). Shih: <https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/07/the-impact-of-covid19-on-womens-and-mens-lives-and-livelihoods>

NDIKIMI GJINOR I PËRMBYTJEVE TË SHKURTIT 2015 NË SHQIPËRINË JUGLINDORE



1,400
shtëpi fshati u
përmytën

**FERMAT BUJQËSORE
JANË KRYESISHT TË
REGJISTRUARA NË
EMRIN E
BASHKËSHORTËVE**

15,000
ferma dhe
familje u prekën
nga përmytjet

Bujqësia,

kryesisht ajo formale, është burimi
kryesor i ushqimit në zonat e prekura

● Toka bujqësore
shkatërrohet dhe
nuk është prodhuese
për 2 vjet.



● Humbje në bagëti



● Bimët bujqësore të prodhuara kryesisht
për konsum vetjak/familjar shkatërrohen
- më pak ushqim për njerëzit



● Mungesë ose ndotje e ujit
të pijshëm, që ndikon në
shëndetin e anëtarëve të
familjes dhe shpenzimet
familjare



● Ngarkesa e punës së grave rritet
mesatarisht me katër orë në ditë,
si rezultat i punës për pastrim
dhe mungesës së furnizimit me
energji



● Rritet dhuna kundër grave, ku
gratë kryefamiljare janë më të
rrezikuara



● Ulen të ardhurat



● Shërbimet dalin
jashtë funksionimit
ose bëhen të
paarritshme (shkollat,
kopshitet) çka e shton
barrën e punës së
përkujdesit që duhet
të bëjnë gratë



Në përgjithësi, mbështetja për gratë që punojnë në bujqësi është e kufizuar në
zonat rurale, gratë përbëjnë vetëm dhjetë për qind të personave që aplikojnë për
subvencione dhe të përfituesve nga shërbimet teknike-këshillimore

Burimi: UN Women (2016), bazuar në: UN Women (2015), Pabarazia Gjinore dhe Ndikimet nga
Përmytjet; dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, të dhënat e
vitit 2015 për PBA 2016-2018.

Kornizat e zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë nuk i trajtojnë pabarazitë gjinore në mënyrë të vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse

Shqipëria është aktualisht në procesin e konsolidimit të kornizës së saj të politikave për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë në përputhje me Kornizën Sendai për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2015-2030 (KS ZRRF). Baza ligjore kryesore në këtë fushë është Ligji 49/2019 “Për mbrojtjen civile”, me të cilin u krijua Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC). Në përgjithësi, kapacitetet administrative, infrastruktura dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm, parandalimit, të gatishmërisë dhe reagimit, janë vlerësuar si të pamjaftueshme.¹⁸

Gjatë vlerësimit të performancës së shërbimeve të ZRRF-së pas tërmetit të vitit 2019, vlerësimi VNPF i sektorit të mbrojtjes civile dhe ZRRF-së konstatoi “... kapacitetet e kufizuara njerëzore të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), mungesën e sallave të urgjencës në nivel vendor dhe kombëtar, mungesën e trajnimit për koordinim në rast emergjencash, trajnime dhe mjete të pamjaftueshme, etj.”¹⁹ Përveç këtyre vështirësive të përgjithshme lidhur me kapacitetet, të cilat prekin kryesisht gratë dhe grupet e pafavorizuara, disa nga pengesat më kryesore për integrimin e efektshëm të konsideratave të barazisë gjinore në masat e ZRRF-së përfshijnë pamjaftueshmërinë e njohurive, udhëzimeve dhe mjeteve për mbështetjen e përpjekjeve të aktorëve të përfshirë në ZRRF për të marrë parasysh nevojat e grave dhe vajzave.²⁰

Ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” përfshin disa konsiderata gjinore, si për shembull të drejtën e grave për të kërkuar mbrojtje dhe për t’u trajtuar me përparësi në përgjigjet ndaj emergjencave civile për sigurimin e kushteve të përshtatshme të jetesës, së bashku me fëmijët, të moshuarat/moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara. Megjithatë, është e nevojshme të kryhet një analizë e kujdesshme e ligjit për të vlerësuar nëse dispozitat ekzistuese ofrojnë garanci të mjaftueshme për trajtimin siç duhet të përparësive dhe nevojave të grave gjatë situatave emergjente. Përveç kësaj, analiza gjinore është e nevojshme të kryhet edhe gjatë rishikimit të akteve nënligjore, pasi ofron mundësi të rëndësishme për integrimin gjinor në ZRRF. Për këtë qëllim, Ligji Nr.45/2019 “Për

18 Komisioni Evropian (2021). Raporti për Shqipërinë i vitit 2021. Shih: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en

19 UN Albania (2020). *Albania Post Disaster Need Assessment* (Vlerësimi i nevojave pas fatkeqësive). Shih: <https://albania.un.org/en/46378-albania-post-disaster-needs-assessment-pdna-volume-report-february-2020>

20 Plani i përbashkët i punës i Qeverisë së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara, 2010-2021, Rezultati 4, Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike.

mbrojtjen civile” kërkon partneritet me organizatat e shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e politikave për zbutjen e rreziqeve dhe fatkeqësive, duke i hapur rrugën një bashkëpunimi më të fortë me organizatat e specializuara të grave.

Fakti që gratë dhe vajzat janë të prekura në mënyrë disproporcionale nga fatkeqësitë dhe kërcënimet e ndryshimeve klimatike njihet në mënyrë adekuate në Strategjinë e parë Kombëtare të Shqipërisë për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030 (“Strategjia ZRRF”) dhe në Planin e saj të Veprimit, miratuar më 22 shkurt 2023.²¹ Strategjia – në përputhje me Kornizën Sendai për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2015-2030 (KS ZRRF) – synon të drejtojë të gjitha aktivitetet dhe investimet e ardhshme në menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vend përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të plotë. Për këtë qëllim, janë bërë përpjekje për të integruar një perspektivë gjinore dhe për të adresuar prioritetet e individëve që janë më të prekshëm nga fatkeqësitë, si gratë, fëmijët, të moshuarat/moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe personat LGBTI+. Më konkretisht, Strategjia përfshin një objektiv të dedikuar për të siguruar rritjen e ndërgjegjësimit dhe ndërtimin e qëndrueshmërisë midis komuniteteve, me fokus të veçantë në parimet e barazisë gjinore (Objektivi 2). Seksioni 6.4 i Strategjisë i referohet qartë rreziqeve të shtuara me të cilat përballen gratë dhe grupet e tjera gjatë fatkeqësive natyrore dhe trajton format e ndërthurura të cenueshmërisë që rrjedhin nga gjinia dhe faktorë të tjerë, si mosha, orientimi seksual, paaftësia, përkatësia etnike, statusi social dhe ekonomik, dhe të tjera. Dokumenti përmban angazhime të rëndësishme në lidhje me barazinë gjinore, duke përfshirë:

- sigurimin që në të gjitha fazat e menaxhimit të rrezikut të fatkeqësive dhe projekteve strategjike të merren parasysh nevojat prioritare të grave dhe grupeve vulnerabël dhe ndikimi i fatkeqësive në mirëqenien e këtyre grupeve;
- miratimin e dispozitave të përgjithshme strategjike për barazinë gjinore dhe cenueshmërinë në nivel vendor gjatë procesit të përgatitjes dhe zbatimit të planeve vendore të veprimit për ZRRF;
- promovimin e pjesëmarrjes së grave dhe rolin e tyre udhëheqës gjatë të gjitha fazave të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë; dhe
- sigurimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në të gjitha projektet, skemat dhe iniciativat që fokusohen në ZRRF, të plotësuar me një listë kontrolli me kritere të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor.

²¹ VKM Nr.94, datë 22.02.2023, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.31, datë 24.02.2023. Shih: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2023/31/099f9b27-e232-4aa5-ae19-20d532632f74>

Pavarësisht këtyre angazhimeve të rëndësishme, Strategjia e ZRRF-së do të kishte përfituar nga përafrimi më i ngushtë me standardet ndërkombëtare dhe të BE-së për integrimin e perspektivës gjinore dhe aplikimin e integritit gjinor të qëndrueshëm. Për shembull, analiza gjinore në Seksionin 6.4 është relativisht e përgjithshme dhe i mungojnë informacionet dhe të dhënat specifike se si gratë ndikohen nga fatkeqësitë në kontekstin shqiptar. Asnjë nga aktivitetet e propozuara në Planin e Veprimit të Strategjisë nuk përmend apo nuk i përgjigjet në mënyrë specifike situatës së grave/vajzave dhe grupeve të tjera të cenueshme. Mungesa në Planin e Veprimit të treguesve të ndjeshëm ndaj gjinisë është problematike, pasi tregues të tillë janë thelbësorë për (i) identifikimin e boshllëqeve gjinore gjatë zbatimit të masave të propozuara; dhe (ii) monitorimin e ndikimit të aktiviteteve të ZRRF mbi gratë/vajzat dhe grupet e cenueshme. Kështu, është e rëndësishme që ekspertiza gjinore dhe ngritja e kapaciteteve të sigurohen gjatë zbatimit dhe monitorimit të Planit të Veprimit për të bërë të mundur që angazhimet e deklaruara të Strategjisë për barazinë gjinore të vihen në funksionim në mënyrë efektive në praktikë.

Dispozitat e ndjeshme gjinore eksplicite në Strategji - në veçanti angazhimi për të siguruar që dispozitat e përgjithshme për barazinë gjinore dhe cenueshmërinë “të miratohen në nivel vendor” gjatë procesit të përgatitjes dhe zbatimit të planeve vendore të veprimit për ZRRF-në - përbëjnë një bazë solide për ta bërë Menaxhimin e ZRRF-së në Shqipëri vërtet të përgjigjshëm gjinor. Megjithatë, është e rëndësishme që termi “të miratohen” i përdorur në Strategji të kuptohet si një proces gjithëpërfshirës ku konsideratat e barazisë gjinore integrohen përgjatë fazave të përgatitjes dhe zbatimit të planeve vendore, në përputhje me rekomandimet e përfshira në këtë Udhëzues për Integrimin Gjinor. (Shih seksionin 4 - Metodatat dhe mjetet kryesore për integrimin gjinor).

Në mars 2023, u miratua dokumenti kombëtar “Për vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror”, që përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt forcimit të sistemit kombëtar të mbrojtjes civile.²² Dokumenti përmban gjashtë vlerësime tematike – një për secilin nga rreziqet kryesore të identifikuara: përmytjet, tërmetet, rrëshqitjet e dheut, rreziqet teknologjike, zjarret dhe sëmundjet infektive. Megjithatë, as dokumenti bazë dhe as vlerësimet tematike nuk përfshijnë konsiderata gjinore, nuk trajtojnë çështjet e barazisë gjinore ose nuk u referohen grupeve të cenueshme.

22 Miratuar me VKM Nr.168, datë 24.03.2023 dhe botuar në Fletoren Zyrtare Nr.51, datë 28.03.2023. Shih: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2023/51/182631e0-3d7c-46d8-bee2-6b37acb60a55>

Ndryshimet klimatike dhe degradimi i mjedisit ndikojnë veçanërisht në jetën dhe mjetet e jetesës së grave

Në Shqipëri, analizat mbi ndikimin e ndryshëm të ndryshimeve klimatike tek gratë dhe burrat janë të kufizuara. Sipas një studimi të kryer në kuadër të Komunikimit të Katërt Kombëtar (KK4), 39 për qind e të anketuarave/anketuarve besojnë se ka dallime ndërmjet grave dhe burrave në aftësitë e tyre reaguese ndaj ndryshimeve klimatike.²³ Deri më tani, analizat në këtë fushë janë fokusuar kryesisht tek bujqësia – një sektor që kërkon punë intensive dhe ku gratë janë mjaft të përfshira: 40,1 për qind e grave punojnë në bujqësi, krahasuar me 28,7 për qind të burrave.²⁴ Prodhimi bujqësor dhe tokat e punueshme bujqësore në Shqipëri janë shumë të varura nga kushtet mjedisore, dhe gjithashtu të parat që vuajnë pasojat e proceseve të trajtimit të mbetjeve, si djegia e tyre. Për shembull, është konstatuar se rënia e prodhimit bujqësor në fshatin Vërrit të Fierit kishte lidhje me ndikimin e djegësit të mbetjeve mbi tokat bujqësore përreth tij. Ky shqetësim u përmend sidomos nga gratë e asaj zone, të cilat i ndjenë drejtpërdrejt pasojat negative të djegësit në të ardhurat e tyre.²⁵

Rritja e dhunës ndaj grave dhe shtimi i orëve të shpenzuara nga gratë për punët e shtëpisë u identifikuan gjithashtu si ndikimet kryesore të ndryshimeve klimatike mbi jetën e grave në anketimin për KK4. Gjithashtu, gratë raportuan shtim më të madh të problemeve shëndetësore, fizike dhe emocionale krahasuar me burrat, pas fatkeqësive të lidhura me klimën. Gratë shtatzëna ndikohen në mënyrë disproporcionale nga problemet lidhur me ndërprerjen e aksesit në shërbime shëndetësore pas fatkeqësive.²⁶ Pas përmbytjeve, gratë preken më shumë nga bronkitet ose infeksionet për shkak të pastrimit të shtëpive me lagështirë. Po kështu, ekspozimi ndaj temperaturave të larta ka pasojat negative për gratë shtatzëna (efekte teratogjenike). Këto ndikime specifike gjinore ndërthuren me faktorë si përkatësia etnike, vendbanimi (sidomos në zonat ku banojnë grupet më të cenueshme të popullsisë), varfëria dhe statusi i emigrimit/imigrimit.

23 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, GEF dhe UNDP (2021). Raporti i parë dyvjeçar i përditësuar për Shqipërinë për Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike (UNFCCC). Shih: <https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/Botimi-i-pare-shqip.pdf>

24 INSTAT (2023). Burra dhe gra në Shqipëri 2023. Shih: <https://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2023/burra-dhe-gra-2023/>

25 Rrjeti i Monitorimit kundër dhunës me bazë gjinore (2019). Raport i organizatave të shoqërisë civile për zbatimin e Platformës për Veprim të Pekinit në Shqipëri, Pekin+25. Shih: <https://www.unwomen.org/sites/default/files/Headquarters/Attachments/Sections/Get%20involved/Beijing-25/Generation-Equality-Forum/CSO-Beijing-Report-Albania-en.pdf>

26 Plani i veprimit i rishikuar për kontributin kombëtar të pikësnyuar për Shqipërinë (2021). Gjendet në: <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/3.-Kontributi-Komb%C3%ABtar-i-Percaktuar-KKP-i-rishikuar-p%C3%ABr-Shqip%C3%ABrin%C3%AB-1.pdf>

Cikli i menaxhimit të mbetjeve është një fushë tjetër në të cilën janë të dukshme dallimet gjinore. Ato përcaktohen nga përgjegjësitë kryesore të grave në familje dhe varen nga perceptimet e ndryshme se cilat janë mbetje dhe cilat jo, si dhe nga sjelljet e ndryshme të grave dhe të burrave si konsumatore/konsumatorë. Proceset e trajtimit të mbetjeve dhe ujërave të zeza ndikojnë në prodhim, ndotjen industriale dhe sjelljet e anëtareve/anëtarëve të familjeve, me pasoja të ndryshme për gratë dhe burrat. Për shembull, gratë ndikohen më tepër nga mungesa e trajtimit të ujërave të zeza dhe nga sistemi jofunksional i kanalizimeve, sepse rreziku i infektimit të grave prej tyre priret të jetë më i lartë krahasuar me rrezikun e infektimit të burrave.²⁷

Mungesa e integritimit gjinor dhe e zërit të grave në politikat dhe masat mbi ndryshimet klimatike

Në Shqipëri, legjislacioni dhe politikat kombëtare ende nuk trajtojnë mjaftueshëm hapat konkretë për integrimin e konsideratave të barazisë gjinore në politikat mbi ndryshimet klimatike. Ndonëse Raporti i Parë Dvjeçar i Përditësuar për Shqipërinë përmban udhëzime për përfshirjen e objektivave të barazisë gjinore në programet dhe planet për zbutjen dhe përshtatjen me ndryshimet klimatike, ato ende nuk janë reflektuar në të gjitha ligjet dhe politikat e kohëve të fundit që lidhen me klimën. Këtu përfshihen Ligji nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike”, Strategjia Kombëtare e Ndryshimeve Klimatike (SKNK) (2020 - 2030) dhe dy shtojcat e saj, Plani Kombëtar i Veprimit për Zbutjen (PKVZ) dhe Plani Kombëtar i Përshtatjes (PKP), miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 466, datë 07.03.2019.²⁸ Gjuha e përdorur në këto dokumente në përgjithësi është e verbër nga këndvështrimi gjinor – sidomos për sa i përket përshkrimit narrativ – dhe në to nuk përcaktohen objektiva apo veprime të posaçme me ndjeshmëri gjinore. Po kështu, konsideratat gjinore mungojnë edhe në politikat dhe planet e tjera të përshtatjes, si për shembull në Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit (2019-2023)²⁹, Dokumentin e Politikave për Pyjet në

27 *United Nations Country Team, Albania (2020). Common Country Analysis.* [Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri (2020). Analizë e Përbashkët e Vendit]. Shih: https://albania.un.org/sites/default/files/2021-02/Web_CCA_2020_final.pdf

28 Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike është një politikë kombëtare me një qasje ndërsektoriale; ajo ka dy shtojca: Planin Kombëtar të Veprimit për Zbutjen (PKVZ) dhe Planin Kombëtar të Përshtatjes (PKP), të cilat gjenden në: https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/2.-Strategjia-e-Ndryshimeve-Klimatike-dhe-Planet-e-Veprimit_Qershor-2019_-1.pdf

29 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (2019). Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023. Shih: <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/Strategjia-Komb%C3%ABtare-e-Turizmit-2019-2023.pdf>

Shqipëri (2019-2030)³⁰ dhe Planin e Integruar Ndërsektorial për zonën Tiranë-Durrës.³¹ ‘Plani i Veprimit për Qytetin e Gjelbër të Tiranës’ ka një seksion specifik për përshtatjen dhe përfshin një sistem pikëzimi për vlerësimin e ndikimit ex ante të veprimeve të propozuara ndaj pesë treguesve socio-ekonomikë, përfshirë barazinë gjinore.³² Informacioni se si u vlerësua fillimisht ndikimi gjinor ose mbi monitorimin e ndikimit gjinor të veprimeve sipas këtij Plani të Veprimit me kalimin e kohës, nuk është i disponueshëm publikisht.

Një nga arsytet për mungesën e perspektivës gjinore në kuadrin ligjor dhe të politikave të Shqipërisë për ndryshimet klimatike është mungesa e grupeve të interesit që përfaqësojnë gratë dhe grupet e pafavorizuara në vlerësimet ex ante dhe gjatë procesit të hartimit të politikave dhe programeve që lidhen me mjedisin dhe ndryshimet klimatike. Organizatat e shoqërisë civile raportojnë se edhe në ato raste kur janë organizuar mbledhje konsultative – për shembull për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ricikluara – në to mungon pjesëmarrja thelbësore e grave në nivel vendor dhe e OJF-ve që veprojnë në komunitet.³³ Megjithatë, përfaqësimi dhe pjesëmarrja aktive e grave dhe grupeve të pafavorizuara në këto procese është detyrim në bazë të Konventës mbi Aksesin në Informacion, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje dhe Aksesin në Drejtësi për Çështje Mjedisore (Konventa e Aarhusit).³⁴

Mungesa e statistikave gjinore mbi ZRRF-në, ndryshimet klimatike dhe mjedisin

Sistemi kombëtar i statistikave në Shqipëri nuk parashikon matje për sa i përket zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë në nivel kombëtar ose vendor. Në raste fatkeqësish ndërmerren matje ad hoc (shih shembujt më poshtë). Mjetet e përdorura për këto matje nuk janë pasqyruar ende në kuadrin kombëtar për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe kornizën monitoruese të tij.

30 Gjendet në: <https://akpyje.gov.al/wp-content/uploads/2023/07/2.-VKM-Nr.-814-date-31.12.2018-Per-miratimin-e-dokumentit-te-politikave-per-pyjet-ne-shqiperi-2019%E2%80%93932030.pdf>

31 Gjendet në: <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/DM-AKPT-Plani-i-Integruar-Ndersektorial-i-Zones-Ekonomike-Tirane-Durres.pdf>

32 Bashkia e Tiranës (2018). Plani i Veprimit për Qytetin e Gjelbër të Tiranës. Gjendet në: <https://ebrdgreencities.com/assets/Uploads/PDF/Tirana-GCAP-Alba.pdf>

33 Rrjeti i Monitorimit kundër dhunës me bazë gjinore (2019). Raport i organizatave të shoqërisë civile për zbatimin e Platformës për Veprim të Pekinit në Shqipëri, Pekin+25. Gjendet në: <https://www.unwomen.org/sites/default/files/Headquarters/Attachments/Sections/Get%20involved/Beijing-25/Generation-Equality-Forum/CSO-Beijing-Report-Albania-en.pdf>

34 UNECE (1998). *Convention on access to information, public participation in decision-making and access to justice in environmental matters*. (Konventa për aksesin në informacion, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe aksesin në drejtësi për çështjet mjedisore). Shih: <https://unece.org/DAM/env/pp/documents/cep43e.pdf>

Shembulli i parë. Matjet e para të rrezikut nga fatkeqësitë me përfshirje të perspektivës gjinore u kryen pas përmbytjeve në jug të vendit në vitin 2015. Vlerësimi gjinor i rrezikut nga fatkeqësitë që u krye nga UN Women përdori mjete matës sasiorë dhe cilësorë.³⁵

Shembulli i dytë. Pas tërmetit të nëntorit 2019, një numër institucionesh shtetërore dhe aktorësh privatë (burime jo administrative) mblodhën të dhëna të disponueshme dytësore dhe informacion parësor. Përveç kësaj, INSTAT-i ndërmori anketime të strukturuar mbi sigurinë e ndërtesave, një anketë të bizneseve dhe një anketë të mjeteve të jetesës, me fokus mbi gratë dhe burrat e mbetur pa strehë të cilat/cilët ishin strehuar në hotele dhe çadra. Metodologjia e përdorur nga INSTAT-i u bazua në atë të përdorur në Statistikat e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës së BE-së (EU-SILC / SANJ) dhe në Anketën e Buxhetit të Familjes (ABF), si anketat më të konsoliduara që ekzistojnë për familjet në nivel kombëtar. Në rastin e tërmetit të nëntorit 2019, metoda që u përdor për mbledhjen e të dhënave nga INSTAT, lejon përlllogaritjen e tre treguesve specifikë gjinorë të propozuar nga UN ESCAP (Komisioni Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara për shtetet e Azisë dhe të Paqësorit) dhe grupi i punës i UN Women³⁶:

- (i) Numri i vdekjeve, i personave të humbur dhe i personave të prekur drejtpërdrejt nga fatkeqësitë, i ndarë sipas seksit.
- (ii) Numri i personave banesat e të cilëve janë dëmtuar si pasojë e fatkeqësive, i ndarë sipas seksit.
- (iii) Numri i personave të cilëve iu vështirësua jetesa ose iu shkatërruan mjetet e jetesës, i ndarë sipas seksit.

Shembulli i tretë. Gjatë pandemisë së Covid-19, Shqipëria u përfshi në nismën globale të UN Women për matjen e ndikimit social-ekonomik të mbylljes. U hartua një metodologji e konsoliduar e cila u zbatua njëtrajtësisht në të gjitha vendet dhe rajonet e botës, duke siguruar kështu krahasueshmërinë e të dhënave.

35 UN Women - *Women's Resilience to Disasters Knowledge Hub (2021). Gender inequality, earthquake and flood impacts in Albania.* [Qendra e njohurive për qëndrueshmërinë e grave ndaj fatkeqësive (2021). Pabarazia gjinore, ndikimet e tërmeteve dhe përmbytjeve në Shqipëri]. Shih: <https://wrd.unwomen.org/index.php/explore/library/gender-inequality-earthquake-and-flood-impacts-albania>

36 Departamenti i Statistikave i UN ESCAP, IUCN, UNEP dhe UN Women (2019). *Mainstreaming gender in environment statistics for the SDGs and beyond: Identifying priorities in Asia and the Pacific.* (Integrimi gjinor në statistikat mjedisore për OZHQ-të dhe më tej: Identifikimi i përparësive në shtetet e Azisë dhe Paqësorit. Seria e dokumenteve të punës SD/WP/10 tetor). Shih: <https://repository.unescap.org/handle/20.500.12870/1138?locale-attribute=es>

KUTIA 2

Përmbledhje e çështjeve kryesore gjinore në fushat e ZRRF-së dhe të ndryshimeve klimatike në Shqipëri

- Gratë përballen me më shumë pasoja të drejtpërdrejta të fatkeqësive.
- Kornizat ekzistuese për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë, nuk i trajtojnë pabarazitë gjinore në mënyrë të vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse.
- Ndryshimet klimatike dhe degradimi i mjedisit ndikojnë specifikisht jetën dhe mjetet e jetesës së grave.
- Mungesa e integritimit gjinor dhe e zërit të grave në politikat dhe masat lidhur me ndryshimet klimatike.
- Mungesa e statistikave gjinore mbi ZRRF-në, ndryshimet klimatike dhe mjedisin.

KUTIA 3

Diskriminimi gjinor i drejtpërdrejtë ose sistemik (i tërthortë)

Njerëzit shpesh supozojnë se diskriminimi në bazë të seksit ose gjinisë vjen nga një arsye e qëllimshme për të përjashtuar ose lënë në disavantazh një seks ose gjini. Diskriminimi i drejtpërdrejtë sigurisht përfshin veprime të tilla të qëllimshme, por përfshin gjithashtu vendime të marra bazuar në paragjykimë ose stereotipe, ku karakteristika të caktuara i atribuohen një individi bazuar në seksin ose gjininë e tij. Për shembull, supozime të tilla si “gratë nuk mund të ngasin kamionë të mëdhenj” ose “burrat nuk dinë të kujdesen për foshnjat”, ose “burrat homoseksualë nuk janë të fortë” mund të parandalojnë që të merren parasysh aftësitë, përvoja dhe atributet e një individi, duke rezultuar në diskriminim ndaj tyre bazuar në gjininë, orientimin seksual ose identitetin gjinor të perceptuar.

Diskriminimi sistematik ose i tërthortë nuk kuptohet gjerësisht edhe mes njerëzve që mbrojnë barazinë gjinore. Shpesh ai nuk është i dukshëm pa një analizë të qartë gjinore të ndikimeve të ndryshme të një ngjarjeje apo politike. Për shembull, një program rikuperimi i bazuar në kompensimin për pronaret/pronarët e tokës ose pronave tingëllon i drejtë, por në shumicën e rasteve, ky program (a) nuk do të ofronte asnjë mbështetje për njerëzit më të varfër dhe (b) do t'u jepte përparësi burrave ndaj grave, nëse në këtë kontekst burrat kanë më shumë gjasa të emërtohen në titujt e pronësisë martesore, ose burrat në përgjithësi kanë më shumë asete dhe për këtë arsye marrin mbështetje më të madhe ekonomike në proceset e rimëkëmbjes. Programet e jetesës që fokusohen vetëm në punësimin formal mund të kenë të njëjtin efekt. Ky është diskriminim i tërthortë ose sistematik, kur një politikë në dukje neutrale ka efektin e dëmtimit të një grupi, edhe nëse ky nuk ishte synimi.

Burimi: UNDRR (2023), *A Review of Gender and the Sendai Framework*, United Nations Office for Disaster Risk Reduction (UNDRR), [Një rishikim i gjinisë dhe Kornizës Sendai, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë (UNDRR)], shih: <https://www.undrr.org/publication/review-gender-and-sendai-framework>

2 BARAZIA GJINORE NË POLITIKAT PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE ZRRF-NË NË KONTEKSTIN E ANËTARËSIMIT NË BE

Krizat aktuale klimatike dhe mjedisore e kanë shtyrë BE-në që të jetë shumë aktive në përpjekjet për zvogëlimin e ndikimeve mbi mjedisin, si brenda BE-së ashtu edhe në nivel global, përfshirë edhe në kuadër të veprimeve të saj humanitare. Në vitin 2021, BE-ja miratoi një varg propozimesh, të njohura me emrin ‘Pakti i Gjelbër Evropian’, që synojnë të pakësojnë shkarkimet e gazeve me efekt serrë dhe ta kthejnë Evropën në kontinentin e parë neutral nga pikëpamja klimatike në botë deri në vitin 2050. BE-ja i kushton vëmendje të veçantë masave dhe investimeve për përbalimin e ngjarjeve të shkaktuara nga klima dhe moti, të cilat kërkojnë dhënien e ndihmës humanitare përmes programeve dhe instrumenteve të posaçme, ndër të cilat: (i) një grup masash për uljen e numrit të humbjeve të jetës dhe të burimeve (gatishmëria për përbalimin e fatkeqësive); (ii) një sistem për paralajmërim të hershëm dhe informim për monitorimin e rreziqeve dhe ngjarjeve të rrezikshme në mbarë botën; dhe (iii) një instrument financimi për t’iu përgjigjur emergjencave të papritura (paketa e emergjencave).³⁷

Komisioni Evropian po luan një rol pararojë në promovimin e veprimeve për zvogëlimin e rrezikut dhe veprimeve parashikuese. Si nënshkrues i Kornizës Sendai, Komisioni Evropian mbështet integrimin në të gjitha politikat dhe programet e BE-së të një qasjeje të bazuar në informacionet për rreziqet dhe vënien në rrezik. Përparësitë e përgjithshme të politikave të BE-së lidhur me mjedisin dhe klimën janë identifikuar në Programin e Tetë për Veprim Mjedisor (PTVM), që bazohet në Paktin e Gjelbër Evropian dhe që do të drejtojë politikat mjedisore evropiane deri në vitin 2030.³⁸

Me Paktin e Gjelbër Evropian, Evropa hyn në rrugën e shndërrimit të saj në kontinentin e parë neutral nga pikëpamja klimatike deri në vitin 2050, ndërkohë që Strategjia e parë e Barazisë Gjimore e BE-së synon që ta bëjë barazinë gjimore realitet në Bashkimin Evropian. Krijimi i sinergjive ndërmjet këtyre dy strategjive është më i rëndësishëm se kurrë sot, në kontekstin e mbështetjes së rimëkëmbjes së Evropës nga kriza e Covid-19 përmes promovimit të tranzicionit të gjelbër dhe digjital në mënyrë përfshirëse.

37 Komisioni Evropian (2022). *European Civil Protection and Humanitarian Aid Operations, Climate Change and Environment Factsheet*. (Mbrojtja civile dhe operacionet e ndihmës humanitare evropiane, fleta e të dhënave mbi ndryshimet klimatike dhe mjedisin). Shih: https://ec.europa.eu/echo/what/humanitarian-aid/climate-change-and-environment_en

38 Komisioni Evropian (2022). *Environment action programme to 2030*. (Programi i veprimit për mjedisin deri në vitin 2030). Shih: https://ec.europa.eu/environment/strategy/environment-action-programme-2030_en#related-topics

Ndryshimet klimatike dhe fatkeqësitë ndikojnë në të drejtat ekonomike dhe shoqërore si të grave, ashtu edhe të burrave. Megjithatë, ka ndikime të diferencuara gjinore të cilat shpesh bëjnë që gratë – edhe ato në vendet e BE-së – të jenë më të rrezikuara dhe më të cenueshme nga ndryshimet klimatike. Për këtë arsye, është e rëndësishme të bëhet monitorimi i dallimeve gjinore në rezultatet e politikave të ndryshimeve klimatike, në mënyrë që të identifikohen reformat e nevojshme në sistemet e mbrojtjes nga klima dhe që reagimet për përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike të jenë të ndjeshme nga pikëpamja gjinore dhe të promovojnë barazinë gjinore, zhdukjen e varfërisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm.³⁹ Disa nga dokumentet kryesore të politikave të BE-së mbi ndryshimet klimatike, ZRRF-në dhe barazinë gjinore përfshijnë:

- Përfundimet e Këshillit të Evropës mbi Ndryshimet Klimatike dhe Zhvillimin, të vitit 2009, theksojnë “përmasën njerëzore të ndryshimeve klimatike, përfshirë edhe perspektivën gjinore, dhe se të varfërat/varfrit janë më të rrezikuarat/rrezikuarit dhe se duhet të forcohet aftësia e tyre ripërtëritëse përballë ndryshimeve klimatike”. Dokumenti gjithashtu thekson nevojën për të siguruar që në hartimin e strategjive të përshtatjes “vëmendje e veçantë i duhet kushtuar barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave”;⁴⁰
- Përfundimet e Këshillit mbi Barazinë Gjinore dhe Mjedisin, të vitit 2012, ku thuhet që përparimi në vendimmarrje, kualifikime dhe konkurrueshmëri në fushën e politikave për zbutjen e ndryshimeve klimatike në BE, luan rol të rëndësishëm në fokusin që u jepet çështjeve gjinore në të gjitha politikat mjedisore të BE-së;⁴¹
- Rezoluta e Parlamentit Evropian e 20 prillit 2012 mbi gratë dhe ndryshimet klimatike (2011/2197(INI)), Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian, 2012, Luksemburg;⁴²

39 Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) (2016). *Gender in environment and climate change*. (Gjinia në mjedis dhe ndryshimet klimatike). Shih: <https://eige.europa.eu/topics/environment-and-climate-change>

40 Këshilli i Bashkimit Evropian (2009). *Conclusions on Climate Change and Development*. (Përfundime mbi ndryshimet klimatike dhe zhvillimin). Shih: https://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/ec/108622.pdf

41 Këshilli i Bashkimit Evropian (2012). *Conclusions on Gender Equality and the Environment*. (Përfundime mbi barazinë gjinore dhe mjedisin). Gjendet (në gjuhën angleze) në: <https://www.cedefop.europa.eu/en/news/council-conclusions-gender-equality-and-environment-enhanced-decision-making>

42 Shih: https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-7-2012-0145_EN.html

- Rezoluta e Parlamentit Evropian e 11 shtatorit 2012 mbi gratë dhe ekonominë e gjelbër (2012/2035(INI)), Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian, 2012, Luksemburg.⁴³

Programi (më i fundit) i Tetë i Veprimit Mjedisor (PTVM) i BE-së (2022) njeh ndikimet specifike gjinore të ndryshimeve mjedisore. Ai pranon faktin se rolet e ndryshme gjinore bëjnë që gratë dhe burrat të ndikohen në mënyra të ndryshme edhe për sa i përket ndryshimeve klimatike, dhe se ndryshimet klimatike i përkeqësojnë pabarazitë gjinore ekzistuese. Programi i Tetë i Veprimit Mjedisor kërkon posaçërisht integrimin gjinor në të gjitha politikat për klimën dhe mjedisin, ndër të tjera edhe përmes përfshirjes së një perspektive gjinore në të gjitha fazat e procesit të politikëbërjes.⁴⁴

KUTIA 4

Shembuj të integritimit gjinor në ZRRF

Sipas një studimi të vitit 2017 në **Nepal**, 71 për qind e burrave i merrnin njoftimet paraprake për fatkeqësitë natyrore nga burime zyrtare, ndërsa shumica e grave, rreth 51 për qind e tyre, i merrnin njoftimet nga burime jozyrtare dhe nga rrethi i tyre social. Për të gjetur zgjidhje për këtë problem dhe probleme të tjera, Strategjia e ZRRF-së e Nepalit (2018-2030) kërkon integrimin gjinor në të gjitha politikat dhe praktikrat, dhe angazhohet që të promovojë gratë në proceset e vendimmarrjes në këtë fushë. Strategjia gjithashtu parashikon ndarjen e të dhënave të ZRRF-së sipas seksit dhe përmban një numër veprimtarish strategjike që synojnë mbrojtjen dhe reagimin ndaj nevojave specifike të grave gjatë fatkeqësive natyrore.

Burimi: <https://reliefweb.int/report/nepal/national-policy-and-strategic-action-plan-disaster-risk-reduction-and-management-2018>; për më shumë informacion, shih: *Practical Action (2017), Gender transformative early warning systems: Experiences from Nepal and Peru, Veprimi praktik (2017), [Sistemet e paralajmërimit të hershëm transformues gjinor: Përvoja nga Nepali dhe Peruja]*, gjendet (në gjuhën angleze) në: https://wrd.unwomen.org/sites/default/files/2021-11/GENDER~1_1.PDF



43 Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52012IP0321>

44 *DECISION (EU) 2022/591 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 6 April 2022 on a General Union Environment Action Programme to 2030.* [Vendimi (BE) 2022/591 i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit i datës 6 prill 2022 për një program të përgjithshëm veprimi për mjedisin deri në vitin 2030]. Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32022D0591&from=EN>



Tërmeti i vitit 2011 në **Japoninë Lindore**, shkaktoi shumë probleme për arsye të mungesave në rezerva, në ndihmë, dhe në pajisjet e qendrave operative dhe të shpëtimit. Ndër mangësitë kryesore ishin mungesa e ndihmës së posaçme për gratë si dhe mungesa e vendeve për ushqyerje me gji, banjave dhe dhomave të veshjes për gratë. Rrjedhimisht, Plani i ZRRF-së i Japonisë, i miratuar në vitin 2016, parashikon detyrimin për të marrë parasysh nevojat specifike të grave dhe burrave në të gjitha aspektet e menaxhimit të fatkeqësive natyrore, përfshirë për sa i përket parandalimit, reagimit ndaj emergjencave, rimëkëmbjes dhe rindërtimit. Ky plan kërkon gjithashtu pjesëmarrjen e grave në forumet vendimmarrëse lidhur me menaxhimin e fatkeqësive dhe rindërtimin. Përveç detyrimit në nivel qendror, ky detyrim ekziston edhe për organet e qeverisjes vendore dhe planet e ZRRF-së në nivel vendor.

Shih: http://www.bousai.go.jp/kaigirep/hakusho/pdf/H30_hakusho_english.pdf

Strategjia Kombëtare e Finlandës për Menaxhimin e Krizave Civile, miratuar në vitin 2014, përfshin parimet e barazisë shoqërore dhe gjinore dhe të mosdiskriminimit në të gjithë sektorët e menaxhimit të krizave civile. Përveç kësaj, në vitin 2019, gjatë përditësimit të Strategjisë për klimën dhe energjinë të vitit 2016, Finlanda kreu një vlerësim të ndikimit gjinor, i cili tregoi se ndërthurja e gjinisë, shkarkimeve klimatike, dhe qëndrimeve klimatike krijojnë një grup të konsiderueshëm faktorësh: u konstatua se veprimtaritë e burrave rezultojnë në nivele më të larta shkarkimesh të ndotësve të mjedisit, sepse sektorët në të cilët burrat priren të punojnë dhe vendimet ata priren të marrin si konsumatorë shkarkojnë më shumë shkarkime; gratë ishin më të gatshme të merrnin masa të favorshme klimatike në jetën private si edhe në punë dhe përgjithësisht në shoqëri; megjithatë ato shpesh nuk përfshihen në vendimmarrjet që lidhen me shkarkimet e ndotësve në mjedis.

Shih: https://vnk.fi/documents/10616/1098657/J1014_National+Strategy+for+Civilian+Crisis+Management.pdf; <https://www.iea.org/policies/6367-national-energy-and-climate-strategy-of-finland-for-2030>; dhe <https://www4.unfccc.int/sites/SubmissionsStaging/Documents/202111090956--SI-11-09-2021%20EU%20Submission%20on%20Gender.pdf>





Strategjia për Barazinë Gjinore e Republikës së Çekisë 2021-2030 thekson rëndësinë e përfshirjes së perspektivës së barazisë gjinore në agjendën e politikave të mbrojtjes së mjedisit dhe transportit. Strategjia mbështet projekte kërkimore që hulumtojnë ndikimet specifike të ndryshimeve klimatike mbi pabarazitë gjinore. Gjithashtu, në të propozohen udhëzime për integrimin e objektivave të barazisë gjinore në hartimin dhe zbatimin e politikave që lidhen me mbrojtjen e mjedisit. Disa shembuj të kësaj janë (i) zbatimi i parimit të barazisë gjinore në të gjithë sektorët për programet e subvencioneve në fushën e mbrojtjes së mjedisit; dhe (ii) kryerja e analizave për ndikimet e diferencuara shëndetësore dhe shoqërore të kushteve të pafavorshme mjedisore tek gratë dhe burrat.

Shih: <https://www4.unfccc.int/sites/SubmissionsStaging/Documents/202111090956---SI-11-09-2021%20EU%20Submission%20on%20Gender.pdf> dhe <https://www.vlada.cz/assets/ppov/gcfge/Gender-Equality-Strategy-2021-2030.pdf>

Që në fillim të procesit të hartimit të **Planit Kombëtar të Spanjës për Përshtatjen me Ndryshimet Klimatike (PKSPNK) 2021-2030**, perspektiva gjinore, përgjigjshmëria gjinore në veprimet klimatike dhe konsultimet me pjesëmarrje ishin elementë thelbësorë të tij. PKSPNK-ja integron një perspektivë gjinore përmes përfshirjes së qasjes gjinore si një prej aspekteve ndërsektoriale që duhet të merret parasysh në hartimin e të gjitha politikave dhe masave të përshtatjes. Së pari, analiza e PKSPNK-së për cenueshmërinë bazohet në variabla sociale dhe demografike, duke përfshirë gjininë. Së dyti, PKSPNK-ja identifikon linja specifike veprimi për integrimin e perspektivës gjinore në planet e përshtatjes. Ndër masat e posaçme për këtë qëllim janë: (i) mbledhja e të dhënave të ndara sipas seksit dhe hartimi i treguesve të ndjeshëm gjinorë; (ii) marrja parasysh e dallimeve specifike gjinore në lidhje me aksesin në informacion dhe trajnime, si dhe në perceptimet e rrezikut, sjelljet mjedisore dhe mënyrën e jetesës; dhe (iii) promovimi i pjesëmarrjes së grave në forumet vendimmarrëse, duke njohur rolin e grave si agjente të ndryshimit.

Shih: <https://www4.unfccc.int/sites/SubmissionsStaging/Documents/202111090956---SI-11-09-2021%20EU%20Submission%20on%20Gender.pdf> dhe https://www.miteco.gob.es/es/cambio-climatico/temas/impactos-vulnerabilidad-y-adaptacion/pnacc-2021-2030-en_tcm30-530300.pdf

3 LIDHJA E GJINISË NË NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE ZRRF-SË ME ACQUIS E BE-SË PËR BARAZINË GJINORE

Integrimi gjinor është një strategji që synon përfshirjen e një **këndvështrimi gjinor** në përgatitjen, hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave, strategjive, buxheteve, programeve të shpenzimeve, aktiveve të projekteve, masave rregullatore, funksioneve administrative dhe kulturës institucionale, me synim promovimin e **barazisë ndërmjet grave dhe burrave**, si dhe parandalimin dhe eliminimin e diskriminimit.

Integrimi gjinor siguron që hartimi i politikave dhe puna legjislative të jenë të një cilësie më të lartë dhe që politikat t'u përgjigjen më me efektivitet nevojave të të gjitha/gjithë qytetareve/qytetarëve – gra dhe burra, vajza dhe djem. Me integrimin gjinor, ndërhyrjet publike bëhen më efektive dhe sigurojnë që pabarazitë të mos vazhdojnë të përsëriten në të ardhmen.

Objektivi kryesor i programeve të BE-së në vendet e (para)anëtarësimit është që shtetet candidate të mbështeten në punën për miratimin dhe zbatimin e të gjitha reformave (politike, institucionale, ligjore, administrative, shoqërore dhe ekonomike), të cilat kërkohet të jenë në përputhje me vlerat dhe të përafuara me rregullat, standardet, politikat dhe praktikën e BE-së. Kriteret e anëtarësimit (kriteret e Kopenhagës) përmbajnë parakushte të qarta për ekzistencën e institucioneve demokratike që garantojnë demokracinë, shtetin ligjor, të drejtat e njeriut, respektimin dhe mbrojtjen e pakicave.⁴⁵ Barazia gjinore, si një prej parimeve kryesore të shtetit ligjor, është pjesë përbërëse e pandarë e Strategjisë së Zgjerimit të BE-së.⁴⁶ Zgjerimi kërkon nga secili vend kandidat për anëtarësim që të miratojë të drejtat dhe detyrimet e përbashkëta (*acquis* e BE-së), të cilat janë të detyrueshme për të gjitha vendet anëtare të BE-së.⁴⁷ Barazia gjinore është pjesë përbërëse e proceseve të anëtarësimit dhe të harmonizimit të legjislacionit, përmes zbatimit të këtyre parimeve që burojnë nga qasja e bazuar në të drejtat e njeriut: (i) ligjshmëria, universaliteti dhe pandashmëria e të drejtave të njeriut; (ii) pjesëmarrja; (iii) mosdiskriminimi; (iv) llogaridhënia dhe përgjegjshmëria; dhe (v) transparenca në çdo hap të programimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të mbështetjes së BE-së.

45 Përfundimet e Presidencës së Këshillit Evropian, Kopenhagë, 21-22 qershor 1993.
Shih: <https://www.consilium.europa.eu/media/21225/72921.pdf>

46 Komunikatë e Komisionit drejtuar Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social dhe Komitetit të Rajoneve. *A credible enlargement perspective for and enhanced EU engagement with the Western Balkans, 2018*. (Një perspektivë e besueshme për zgjerimin dhe rritjen e angazhimit të BE-së me Ballkanin Perëndimor, 2018), fq.4. Gjendet (në gjuhën angleze) në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52018DC0065>

47 Shih: <https://eur-lex.europa.eu/summary/glossary/acquis.html>

Në nivelin e BE-së, detyrimi për t'u angazhuar për integrimin gjinor buron, ndër të tjera, nga:

- Traktati i Bashkimit Evropian (TBE);⁴⁸
- Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE)⁴⁹ nenet 8 dhe 10, ku përcaktohen detyrimet e BE-së dhe të shteteve anëtare për të siguruar përfshirjen e objektivave të barazisë gjinore në të gjitha veprimtaritë e BE-së;
- Direktiva 2004/113/EC e Këshillit e datës 13 dhjetor 2004⁵⁰, 'Mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në lidhje me aksesin dhe ofrimin e mallrave dhe shërbimeve';
- Direktiva 2006/54/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 5 korrik 2006⁵¹ 'Mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në punësim' (Direktiva e rishikuar).

Gjithashtu, integrimi gjinor është i pasqyruar qartësisht në Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP) III të BE-së (2021-2025)⁵² dhe është pjesë përbërëse e Rregulloreve të Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit të BE-së (IPA III)⁵³: **për t'u anëtarësuar në BE, vendeve candidate u kërkohet që të**

48 Version i konsoliduar i Traktatit të Bashkimit Evropian (TBE). Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A12012M%2FTXT>

49 Version i konsoliduar i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE). Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A12012E%2FTXT>

50 Direktivë e Këshillit Nr. 2004/113/EC e datës 13 dhjetor 2004, '*Implementing the principle of equal treatment between men and women in the access to and supply of goods and services*'. ('Mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në lidhje me aksesin dhe ofrimin e mallrave dhe shërbimeve'). Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32004L0113>

51 DIREKTIVA 2006/54/EC E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, e datës 5 korrik 2006 '*On the implementation of the principle of equal opportunities and equal treatment of men and women in matters of employment and occupation*'. ('Mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në punësim') (Direktiva e rishikuar). Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32006L0054>

52 Komunikatë e përbashkët e Parlamentit Evropian dhe Këshillit: Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP) III i BE-së – Një agjendë ambicioze për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në veprimin e jashtëm të BE-së. Shih: https://international-partnerships.ec.europa.eu/document/download/c8b9cff0-d155-4762-bd2d-2871a847956e_en?filename=join-2020-17-final_Len.pdf; EU GAP III është plotësisht i harmonizuar me instrumentet ndërkombëtare si: Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW); Platforma për Veprimin e Pekinit (BPfA); dhe Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 'Gratë, Paqja dhe Siguria' (UNSCR 1325).

53 RREGULLORJA (BE) 2021/947 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT e datës 9 qershor 2021 për krijimin e Instrumentit të Fqinjësisë, Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar – Evropa Globale; ndryshon dhe shfuqizon Vendimin nr. 466/2014/EU dhe shfuqizon Rregulloren (BE) 2017/1601 dhe Rregulloren e Këshillit (KE, Euratom) nr. 480/2009. Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32021R0947&from=EN>

përmbushin detyrimet e përcaktuara në *acquis* për barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin.

Në **nivel ndërkombëtar**, Shqipëria është palë nënshkruese ose ka ratifikuar traktatet dhe instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare sipas të cilave vendi ka detyrimin të mbrojtë dhe të mbështesë të drejtat e grave dhe barazinë gjinore, përfshirë:

- Konventën e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW të UN);⁵⁴
- Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit);⁵⁵
- Deklaratën dhe Platformën për Veprim të Pekinit (BPfA);⁵⁶
- Rezolutën 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara “Gratë, Paqja dhe Siguria” (UNSCR 1325)⁵⁷; dhe
- Konventat Themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO)⁵⁸, si dhe Konventën C190 të ILO lidhur me Eliminimin e Dhunës dhe Ngacmimit në Botën e Punës.⁵⁹

Ligji i BE-së për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP) III i BE-së janë të përafuara me dokumentet e lartpërmendura dhe si të tillë përbëjnë një pjesë integrale të procesit të anëtarësimit në BE.

Në nivel kombëtar, Kushtetuta e Shqipërisë ndalon diskriminimin për shkak të gjinisë (Neni 18/2).⁶⁰ Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008, “Për barazinë gjinore në

54 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (1979) Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) Shih: <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-elimination-all-forms-discrimination-against-women>

55 Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje. Shih: <https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/home>

56 Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (1995). Shih: <https://www.un.org/womenwatch/daw/beijing/pdf/BDPfA%20E.pdf>

57 Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara “Gratë, paqja dhe siguria” (2000) Shih: <https://www.unwomen.org/en/docs/2000/10/un-security-council-resolution-1325>

58 Konventat dhe Rekomandimet e ILO-s (në internet). Shih: <https://www.ilo.org/global/standards/introduction-to-international-labour-standards/conventions-and-recommendations/lang--en/index.htm>

59 ILO (2019). Konventa Nr. 190 lidhur me Eliminimin e Dhunës dhe Ngacmimit në Botën e Punës: https://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO::P12100_ILO_CODE:C190; për më shumë informacion shih: <https://www.ilo.org/global/topics/violence-harassment/lang--en/index.htm>

60 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Gjetet në: <https://qbz.gov.al/preview/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd>

shoqëri⁶¹ përkufizon termin “integrim gjinor”. Ligji nr.10221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar në vitin 2020⁶², detyron të gjitha autoritetet publike të promovojnë barazinë dhe të parandalojnë diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre (neni 7, “Mbrojtja nga diskriminimi”). Për më tepër, ligji trajton edhe aspekte si diskriminimi strukturor dhe diskriminimi për shkak të përkatësisë së shumëfishtë (intersectional discrimination), si dhe eliminimi i privilegjeve.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021-2030, e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 30.06.2021, në qëllimin strategjik IV përcakton “Aplikimin e integritimit gjinor si mjeti kryesor për arritjen e barazisë dhe drejtësisë gjinore në shoqëri”.⁶³ Ajo parashikon monitorimin e strategjive të reja të cilat duhet të integrojnë këndvështrimin gjinor, si dhe caktimin e buxheteve përkatëse në nivel qendror dhe të vetëqeverisjes vendore. Në këtë kuadër, SKBGJ-ja përcakton kuadrin strategjik për integrimin gjinor në të gjithë sektorët dhe nivelet e qeverisjes.

3.1. Përafrimi me Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP) III të BE-së dhe treguesit përkatës

Sikurse evidentohet në dokumente si raportet dhe dosjet gjinore për Shqipërinë, në vend vazhdojnë të ekzistojnë mangësi të konsiderueshme në trajtimin e çështjeve të pabarazisë gjinore dhe në zbatimin e integritimit gjinor.⁶⁴ Këtu përfshihen fusha të politikave në të cilat statusi i pabarabartë i grave është i mirë dokumentuar dhe i vërtetuar qartë nga të dhënat administrative. Ndër arsytet bazë për këtë janë:

- (i) konceptualizimi stereotipik dhe i gabuar i “qytetarit të zakonshëm”, i cili është burrë;
- (ii) kapacitete dhe aftësi të kufizuara për integrimin gjinor në administratë;

61 Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008, “Për barazinë gjinore në shoqëri”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 125, datë 01.08.2008. Shih: <https://qzb.gov.al/eli/ligj/2008/07/24/9970>

62 Ndryshuar me Ligjin nr. 124/2020. Shih: <https://qzb.gov.al/eli/fz/2020/191/4a6fb792-6c8d-4637-ba0f-fa0ece007562>

63 Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 112, datë 15.07.2021: <https://qzb.gov.al/eli/fz/2021/112>.

64 Komisioni Evropian. Raportet e BE-së për vendin, për vitet 2017, 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022; UNDP dhe UN Women (2016). *Gender Brief Albania*. (Dosja Gjinore Shqipëri); UN Women (2020). *Albania Country Gender Equality Brief*. (Dosja e Barazisë Gjinore e Shqipërisë, 2020).

- (iii) mungesa e detyrimit për të kryer analiza gjinore të rregullta, sipas fushave të politikave; dhe
- (iv) pasqyrimi i dobët i normave dhe standardeve gjinore në proceset, procedurat dhe sistemet e qeverisjes.

Një pengesë e mëtejshme është fakti se individët e përfshirë në hartimin e politikave dhe programeve e kanë të vështirë të përcaktojnë saktësisht se cilat janë çështjet gjinore kryesore në fushat konkrete të punës dhe veprimtarisë së tyre. Si rrjedhojë, shumica dërrmuese e politikave, planeve dhe programeve mbeten pa objektiva konkrete për barazinë gjinore.

Politikat publike hartohen dhe zbatohen me synimin e arritjes së rezultateve të caktuara. Treguesit përvijojnë aspektet rregullatore të arritjes së këtyre rezultateve. Për sa i përket monitorimit të përparimit të bërë në fushën e barazisë gjinore, treguesit e Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021-2025 të BE-së mund të shërbejnë si udhërrëfyes të vlefshëm.⁶⁵ Ata ilustrojnë se çfarë ndryshimi (pra, çfarë rezultatesh) është i nevojshëm të arrihet dhe të matet në jetën e grave/vajzave dhe burrave/djemve, në një fushë të caktuar të politikave.

Në kuadrin e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, integrimi i barazisë gjinore kërkon që objektivat dhe treguesit e GAP III të BE-së të përfshihen gradualisht në kuadrin e politikave të vendit. Për këtë qëllim, tabela në vijim paraqet përafrimin ndërmjet (i) kapitujve përkatës të BE-së për një fushë të caktuar politikash; (ii) dokumenteve përkatëse të politikave kombëtare që do të përshtaten me konsideratat e BE-së për barazinë gjinore; dhe (iii) objektivave dhe treguesve konkretë të GAP III të BE-së që duhet të përfshihen në kornizat kombëtare të monitorimit.

Në Shqipëri, mbledhja dhe disponueshmëria e statistikave gjinore për ZRRF-në, ndryshimet klimatike dhe mjedisin është ende në fazë fillestare. Për këtë arsye, në tabelën më poshtë, burimet e mundshme parësore të të dhënave administrative për përcaktimin e treguesve përkatës të BE-së jepen në një kolonë më vete. Përafrimi plotësohet me listën e treguesve të OZHQ-ve të lidhur me gjininë, të cilët bëjnë lidhjen ndërmjet integritimit gjinor në procesin e anëtarësimit në BE me objektivat e barazisë gjinore në nivel global.

⁶⁵ Komisioni Evropian dhe Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme dhe Politikat e Sigurisë (2020). *Objectives and Indicators to Frame the Implementation of the Gender Action Plan III (2021-25)*. [Objektiva dhe tregues për kornizën e zbatimit të Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore III 2021-2025], f.27. Gjetet (në gjuhën angleze) në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52020SC0284>

TABELA 1

Përafrimi i Kapitullit 27 me treguesit e GAP III të BE-së

Kapitulli 27 - Mjedisi dhe ndryshimet klimatike		
Dokumentet përkatëse të politikave kombëtare	<p>Kontributi i Pikësnyuar Kombëtar për arritjen e objektivave të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike</p> <p>Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike (SKNK) (2020-2030) dhe dy shtojcat e saj: Plani Kombëtar i Veprimit për Zbutjen (PKVZ) dhe Plani Kombëtar i Përshtatjes (PKP)</p> <p>Strategjia Kombëtare e Integruar e Energjisë dhe Klimës, si një angazhim i Republikës së Shqipërisë në Takimin Ministror të Komunitetit të Energjisë (dhjetor 2017)</p> <p>Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit (2019-2023)</p> <p>Politika Kombëtare e Pyjeve (2019-2030)</p> <p>Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030 dhe plani i saj i veprimit</p> <p>Dokumenti kombëtar ‘Për vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë në nivelin qendror’</p>	
Objektivi i Përgjithshëm Tematik përkatës i GAP III të BE-së (impakti)	Gratë, në gjithë diversitetin e tyre, kanë ndikim në proceset e vendimmarrjes për ruajtjen e mjedisit dhe politikat dhe veprimet lidhur me ndryshimet klimatike	Burimi parësor i të dhënave administrative
Treguesit e Përgjithshëm Tematikë përkatës të Ndikimit të GAP III të BE-së	% e grave në poste drejtuese në të gjithë sektorët, ministritë ose institucionet që kanë lidhje me klimën, mjedisin dhe mbrojtjen civile, autoritetet e energjisë elektrike, bordet e energjisë, autoritetet rregullatore, shërbimet komunale, agjencitë e energjisë së ripërtëritshme, etj.	Departamenti i Administratës Publike (DAP)
	% e grave sipërmarrëse në ekonominë e gjelbër ose ekonominë rrethore	INSTAT

Objektivat tematike përkatëse të GAP III të BE-së (rezultatet)	Pjesëmarrja më e madhe e grave dhe vajzave në gjithë diversitetin e tyre, në proceset e vendimmarrjes mbi çështje të mjedisit dhe ndryshimeve klimatike	do të përcaktohet më vonë - nevojiten studime të mëtejshme
	Strategjitë dhe marrëveshjet për zbutjen e ndryshimeve klimatike, përshtatjen, zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe biodiversitetit janë më të përgjigjshme gjinore në nivel vendor, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar	do të përcaktohet më vonë - nevojiten studime të mëtejshme
	Kontributi i grave, burrave, vajzave dhe djemve, në gjithë diversitetin e tyre, të cilat/cilët trajtojnë problemet e ndryshimeve klimatike në jetën e tyre të përditshme dhe ruajnë mjedisin natyror, njihet dhe vlerësohet	do të përcaktohet më vonë - nevojiten studime të mëtejshme
Treguesit specifikë tematikë përkatës të GAP III të BE-së	Numri i grave, burrave, vajzave dhe djemve, në gjithë diversitetin e tyre, që janë aktiviste/aktivistë dhe mbrojtëse/mbrojtës të të drejtave mjedisore, të cilat/cilët veprojnë si agjente/agjentë ndryshimi në luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe që punojnë për drejtësi mjedisore në nivel vendor, kombëtar dhe rajonal, ndarë më së paku sipas seksit	do të përcaktohet më vonë - nevojiten studime të mëtejshme
	Shkalla në të cilën gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, si dhe organizatat e shoqërisë civile dhe aktivistet/aktivistët e tyre janë në gjendje të ndikojnë në strategjitë për zbutjen e ndryshimeve klimatike, përshtatjen, zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe biodiversitetit në nivel vendor, kombëtar dhe rajonal, ndarë më së paku sipas seksit	do të përcaktohet më vonë - nevojiten studime të mëtejshme
	Përqindja e grave në komisionet parlamentare kombëtare që merren me çështje të veprimeve klimatike dhe drejtësisë mjedisore	Kuvendi

•••	Numri i grave, burrave, vajzave dhe djemve, në gjithë diversitetin e tyre, që marrin pjesë në mënyrë të barabartë në mbledhjet publike të planifikimit dhe konsultimit për veprime klimatike në nivel vendor dhe kombëtar, ndarë më së paku sipas seksit	do të përcaktohet më vonë - nevojiten studime të mëtejshme
	Numri i grave, burrave, vajzave dhe djemve, në gjithë diversitetin e tyre, që marrin pjesë në veprime klimatike dhe të drejtësisë mjedisore, ndarë më së paku sipas seksit dhe mundësisht të ndarë edhe sipas rolit: pjesëmarrëse/ pjesëmarrës ose folëse/folës	do të përcaktohet më vonë - nevojiten studime të mëtejshme
	Numri i politikave të përshtatjes dhe të zbutjes të propozuara për miratim (përfshirë kontributet e përcaktuara në shkallë kombëtare) dhe i strategjive dhe planeve për mbrojtjen e mjedisit (përfshirë edhe politikat/strategjitë në fushën e energjetikës) që përfshijnë objektiva të barazisë gjinore, në pajtim me planin e veprimit për barazinë gjinore të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC)	Ministria e Mjedisit
	Shkalla në të cilën politikat për përshtatjen me ndryshimet klimatike dhe për zbutjen e ndryshimeve klimatike, si dhe strategjitë dhe planet për mbrojtjen e mjedisit (përfshirë politikat/strategjitë në fushën e energjetikës), që janë propozuar për miratim, bazohen në një analizë gjinore të rrezikut, nevojave, kërkesave, pengesave dhe të kapaciteteve furnizuese	do të përcaktohet më vonë - nevojiten studime të mëtejshme
	Shkalla në të cilën politikat, strategjitë dhe planet mjedisore bazohen në vlerësime të rrezikut dhe të cenueshmërisë dhe në analizën e konflikteve gjinore, të ndikimeve të ndryshme të ndryshimeve klimatike dhe të degradimit mjedisor tek gratë dhe burrat	do të përcaktohet më vonë - nevojiten studime të mëtejshme

•••	Disponueshmëria e të dhënave cilësore në sektorin e mbrojtjes së mjedisit, ndarë më së paku sipas seksit	Ministria e Brendshme, Agjencia e Mbrojtjes Civile
	Shkalla në të cilën zbatohen politikat përfshirëse të zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë	Ministria e Brendshme, Agjencia e Mbrojtjes Civile
	Shkalla në të cilën gratë dhe vajzat kanë mundësi të zgjedhin dhe të ushtrojnë kontroll mbi mundësitë dhe burimet në kontekstet e zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë, rimëkëmbjes dhe rindërtimit	Ministria e Brendshme, Agjencia e Mbrojtjes Civile
	Numri i grave me më shumë qasje në trajnime, burime financiare, teknologjike, dhe burime të tjera për prodhim të qëndrueshëm dhe të sigurt të ushqimit, furnizim të qëndrueshëm me energji, transport të qëndrueshëm dhe burime uji të pastër, për konsum të familjes ose për qëllime prodhimi	do të përcaktohet më vonë - nevojiten studime të mëtejshme
	Numri i grave, burrave, vajzave dhe djemve, të cilat/cilët kanë akses të barabartë në burime të qëndrueshme energjetike, ndarë më së paku sipas seksit	do të përcaktohet më vonë - nevojiten studime të mëtejshme
	Numri i aktivisteve/aktivistëve të të drejtave të njeriut në fushën mjedisore që mund të punojnë dhe veprojnë lirisht, ndarë më së paku sipas seksit	do të përcaktohet më vonë - nevojiten studime të mëtejshme
	Numri i grave dhe vajzave që përfitojnë nga programet që kanë për qëllim forcimin e aftësisë përtëritëse dhe sigurisë vetjake në raste fatkeqësish (mësime noti, ushtrime dhe praktika veprimi për raste emergjente, etj.)	Ministria e Brendshme, Agjencia e Mbrojtjes Civile

Treguesit e OZHQ-ve të lidhura me gjininë	Numri i vdekjeve, numri i personave të zhdukur dhe numri i njerëzve të prekur drejtpërdrejt nga fatkeqësitë për 100,000 banorë (Treguesit e OZHQ-ve 1.5.1, 11.5.1, 13.1.1) [ndarë sipas rrezikut, gjeografisë, seksit, moshës, aftësisë së kufizuar dhe të ardhurave të parashikuara]	INSTAT
--	---	--------

3.2. Instrumenti i Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA) III: integrimi gjinor sipas ‘Rregulloreve të NDICI-t’

Agjenda e Shqipërisë për reforma dhe anëtarësim merr mbështetje të konsiderueshme financiare përmes fondeve të BE-së, si edhe drejtpërdrejt nga shtetet anëtare të BE-së. Bashkimi Evropian, si promovuesi kryesor i barazisë ndërmjet grave dhe burrave në rajon, ka përcaktuar standarde të qarta dhe të përkufizuara shprehimisht në Rregulloret e ‘Instrumentit të Fqinjësisë, Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar’ (NDICI) të Komisionit Evropian që u miratuan në qershor 2021.⁶⁶ Këto rregullore vlejnë edhe për veprimtaritë në kuadër të IPA III të BE-së që do të financohen dhe zbatohen në Shqipëri dhe formulojnë shprehimisht kriteret e barazisë gjinore:

“[...] Forcimi i barazisë gjinore dhe i fuqizimit të grave në veprimin e jashtëm të Bashkimit [Evropian] dhe shtimi i përpjekjeve për të arritur standardet minimale të performancës që përcaktohen në Planet e Veprimit për Barazinë Gjinore të BE-së, duhet të çojnë në një qasje me ndjeshmëri gjinore dhe transformuese në të gjithë veprimin e jashtëm dhe bashkëpunimin ndërkombëtar të BE-së. Të paktën 85 % e veprimeve të reja që do të zbatohen në kuadër të këtij instrumenti duhet të kenë barazinë gjinore si objektiv parësor ose të rëndësishëm, sikurse përkufizohet në vlerësuesin e politikave të barazisë gjinore të Komitetit të Ndihmës për Zhvillim (DAC) të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim OECD-së. Të paktën 5 % e këtyre veprimeve duhet të kenë si objektiv parësor barazinë gjinore, të drejtat dhe fuqizimin e grave dhe vajzave.”

⁶⁶ RREGULLORJA (BE) 2021/947 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT e datës 9 qershor 2021 për krijimin e Instrumentit të Fqinjësisë, Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar – Evropa Globale; ndryshon dhe shfuqizon Vendimin nr. 466/2014/EU dhe shfuqizon Rregulloren (BE) 2017/1601 dhe Rregulloren e Këshillit (KE, Euratom) nr. 480/2009. Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32021R0947&from=EN>

Nën dritën e Rregulloreve të NDICI-t, të cilat parashikojnë objektivin prej 85 për qind veprime me ndjeshmëri gjinore në të ardhmen, qeveria e Shqipërisë duhet të përcaktojë – në terma konkretë – veprimtaritë, strukturat, mekanizmat dhe kapacitetet për zbatimin e veprimeve me ndjeshmëri gjinore, që është kriter dhe parakusht për suksesin në marrjen e fondeve nga IPA III e BE-së.

3.3. Vlerësuesi i politikave për barazinë gjinore i OECD-DAC

Vlerësuesi i politikave për barazinë gjinore i Komitetit të Asistencës për Zhvillim të Organizatës së Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ekonomik (OECD-DAC)⁶⁷ është një instrument tepër i rëndësishëm për kryerjen e monitorimit dhe sigurimin e llogaridhënies në kontekstin e Agjendës 2030. Qëllimi i tij është që të identifikojë mangësitë midis angazhimeve ligjore, politike dhe financiare dhe të nxisë përpjekjet për eliminimin e tyre. Për të gjitha programet/veprimet është e detyrueshme kryerja e një analize gjinore dhe ndjekja e qasjes “mos shkakto dëm”.

Programet/veprimet që janë shqyrtuar kundrejt kriterëve të këtij vlerësuesi dhe janë konstatuar se nuk e përmbajnë si synim barazinë gjinore, klasifikohen në kategorinë me 0 pikë. Vlerësimi me 0 pikë duhet të shoqërohet me një shpjegim përshkruar. Programet/veprimet në të cilat barazia gjinore është objektiv i rëndësishëm dhe i qëllimshëm, por nuk është arsyeja kryesore për kryerjen e programit/veprimit, klasifikohen me 1 pikë. Programet/veprimet në të cilat barazia gjinore është objektiv kryesor dhe themelor qoftë në hartimin, ashtu edhe në rezultatet e pritshme të tyre, klasifikohen me 2 pikë.

Në Rregulloret e NDICI-t të BE-së – të cilat janë të zbatueshme, për shembull, për Dokumentet e Veprimit të IPA III - përmendet shprehimisht detyrimi për zbatimin e kriterëve minimale të përbashkëta për tri kategoritë e vlerësuesit të politikave të barazisë gjinore të DAC të OECD-së. Ato përcaktojnë objektivin që më së paku 85 për qind e të gjitha veprimeve të ndërmarra duhet të përmbushin kriteret për t'u klasifikuar në kategorinë 1, dhe 5 për qind të përmbushin kriteret e kategorisë 2. Në praktikë, klasifikimi me 1 pikë kërkon që veprimet me përgjigjshmëri gjinore të pasqyrohen në nivelin e analizës së problemeve, objektivave, treguesve dhe arritjeve të synuara.

67 OECD DAC Network on Gender Equality (GENDERNET) (2016). *Definition and minimum recommended criteria for the DAC gender equality policy marker*. (Përkufizimi dhe kriteret minimale të rekomanduara për vlerësuesin e politikave të barazisë gjinore të DAC). Shih: <https://www.oecd.org/dac/gender-development/Minimum-recommended-criteria-for-DAC-gender-marker.pdf>

Përkufizimi i Kategorisë 1:

- Barazia gjinore është objektiv i rëndësishëm dhe i qëllimshëm, por jo arsyeja kryesore për kryerjen e projektit/programit.
- Objektivi i barazisë gjinore duhet të jetë i formuluar shprehimisht në dokumentacionin e projektit/programit dhe nuk mund të jetë i nënkuptuar apo të merret me mend.
- Krahas objektivave të tjera, projekti/programi synon të ketë një ndikim pozitiv në përparimin e mëtejshëm të barazisë gjinore dhe/ose të fuqizimit të grave dhe vajzave, redukton diskriminimin gjinor ose pabarazitë, ose plotëson nevoja gjinore specifike.

TABELA 2

Kërkesat minimale për përmbushjen e kriterëve të Kategorisë 1 të vlerësuesit të politikave për barazinë gjinore të OECD-DAC

Niveli	Kriteri	Përmbushja	Veprimi që duhet ndërmarrë për arritjen e tij
Analiza e Problemit	Është kryer një analizë e statusit, rolit, pozicionit dhe gjendjes së grave/vajzave dhe burrave/djemve në lidhje me një fushë të politikave/ sektor/ nënsektor ku është ndërmarrë projekti/programi/veprimi	<input type="checkbox"/>	Në rastet kur analiza gjinore nuk ekziston, ose është e paplotë apo i ka kaluar koha, duhet të porositet/ të ndërmerret një analizë gjinore specifike për sektorin ose nënsektorin
	Konstatimet e nxjerra nga analiza gjinore:		
	- janë përfshirë në përshkrimin e problemit	<input type="checkbox"/>	
	- mbështeten me shifra (statistika gjinore)	<input type="checkbox"/>	
	- janë marrë për bazë në hartimin e projektit/ programit/veprimit	<input type="checkbox"/>	
	Janë përmendur çështjet kryesore të pabarazisë gjinore në fushën e politikave/ sektorin/ nënsektorin konkret	<input type="checkbox"/>	
	Ndërhyrja i përmbahet qasjes “mos shkakto dëm”	<input type="checkbox"/>	
	Të dhënat statistikore dhe treguesit janë ndarë sipas seksit dhe sipas tipareve të tjera të identitetit, aty ku është e zbatueshme	<input type="checkbox"/>	

Objektivat	Prania e të paktën një objektivi të barazisë gjinore (për shembull, formulimi shprehimisht i synimit për arritjen e objektivave të barazisë gjinore), në përputhje me problemet e pabarazisë gjinore të identifikuara dhe detajuara në analizën përshkruese	□	Përfshirja e ekspertizës për integrimin gjinor si pjesë përbërëse e grupeve të punës që hartojnë/ rishikojnë dokumentet
Veprimtaritë	Veprimtaritë e propozuara i përgjigjen posaçërisht situatës së përshkruar të grave/vajzave dhe burrave/djemve, kontribuojnë në arritjen e rezultateve të barazisë gjinore dhe parandalojnë diskriminimin, përfshirë diskriminimin strukturor dhe atë për shkak të përkatësisë së shumëfishtë (intersectional discrimination)	□	Përfshirja e ekspertizës për integrimin gjinor si pjesë përbërëse e grupeve të punës që hartojnë/ rishikojnë dokumentet
Treguesit	Objektivi ose objektivat e barazisë gjinore mbështeten me të paktën një tregues me ndjeshmëri gjinore, që mundëson: <ul style="list-style-type: none"> - identifikimin e dallimeve gjinore në përfitimet nga masat e parashikuara - monitorimin e ndikimit të masave/veprimtarive mbi gratë/vajzat dhe burrat/djemtë 	□	Harmonizimi me treguesit përkatës të BE-së dhe ata globalë (si për shembull, OZHQ-të, Eurostat/GAP III i BE-së, dhe të tjerë të ngjashëm)

Rezultatet e synuara	Caktohen vlera specifike të matshme për gratë /vajzat dhe burrat/djemtë	□	Reflektimi i qëllimit për eliminimin e dallimeve gjinore/ për arritjen e rezultateve në fushën e barazisë gjinore në vlerat që vendosen për matjen e rezultateve të synuara
-----------------------------	---	---	---

Për t'u klasifikuar në kategorinë 2 të vlerësuesit të politikave për barazinë gjinore të DAC të OECD-së, barazia gjinore duhet të jetë objektivi kryesor dhe themelor i projektit/programit, si në hartimin e tij ashtu edhe për sa i përket rezultateve të pritshme. Deri tani, numri dhe fushëveprimi i projekteve të financuara në kuadrin e IPA të BE-së që klasifikohen në Kategorinë 2 është shumë i ulët.

Përkufizimi i Kategorisë 2:

- Barazia gjinore është objektivi kryesor dhe themelor i projektit/programit, si në hartimin e tij ashtu edhe në rezultatet e pritshme. Projekti/programi nuk do të ishte ndërmarrë pa këtë objektiv të barazisë gjinore.
- Synimi parësor dhe kryesor në hartimin e projektit/programit është përparimi i mëtejshëm i barazisë gjinore dhe/ose i fuqizimit të grave dhe vajzave, reduktimi i diskriminimit ose pabarazive, ose plotësimi i nevojave gjinore specifike.

4 METODAT DHE MJETET KRYESORE PËR INTEGRIMIN GJINOR

Ky seksion përmban një numër metodash dhe mjetesh të standardizuara të BE-së për integrimin gjinor që mund të përdoren në rishikimin e politikave, planifikimet strategjike të ministrive të linjës, në programim, hartimin e buxheteve dhe në procese të tjera qeverisëse të ngjashme. Lista e plotë e mjeteve dhe materialeve burimore të standardizuara të BE-së, ku përfshihen edhe përshkrime të hollësishme të mjeteve për integrimin gjinor, gjendet (në gjuhën angleze) në faqen e internetit të Institutit Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE), në këtë adresë: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/methods-tools>

Disa shembuj konkretë se si mund të realizohet integrimi gjinor në politikat mjedisore dhe të ndryshimeve klimatike janë:

- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) (2009). *Gender and environment: A guide to the integration of gender aspects in the OSCE's environmental projects*. (Gjinia dhe mjedisi: udhëzues për përfshirjen e aspekteve gjinore në projektet mjedisore të OSBE-së). Gjendet (në gjuhën angleze) në: <https://www.osce.org/gender/36360>
- Fondi i Gjelbër i Klimës dhe UN Women (2017). *Mainstreaming gender in Green Climate Fund projects*. (Integrimi gjinor në projektet e Fondit të Gjelbër të Klimës). Gjendet (në gjuhën angleze) në: <https://www.greenclimate.fund/document/mainstreaming-gender-green-climate-fund-projects>
- NAP Global Network (Rrjeti Global i PKP-ve) (2020). *Advancing Gender-Responsive Climate Action Through National Adaptation Plan (NAP) Processes. NAP Global Network Synthesis Report, 2019–2020*. [Forcimi i veprimeve klimatike me përgjigjshmëri gjinore përmes proceseve të planeve të përshtatjes (PKP). Raporti i Sintezës së Rrjetit Global të PKP, 2019–2020]. Gjendet (në gjuhën angleze) në: <https://napglobalnetwork.org/wp-content/uploads/2020/05/napgn-en-2020-gender-responsive-nap-processes-synthesis-report-2019-2020.pdf>
- Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) (2022). *Gender and the Environment: Building Evidence and Policies to Achieve the SDGs - 5. Towards a joint gender and environment agenda*. (Gjinia dhe mjedisi: mbledhja e fakteve dhe hartimi i politikave për arritjen e OZHQ-ve – 5. Drejt një agjende të përbashkët për gjininë dhe mjedisin). Gjendet (në gjuhën angleze) në: <https://www.oecd-ilibrary.org/sites/68e6cbf4-en/index.html?itemId=/content/component/68e6cbf4-en>
- UNDP (2016). *Gender, adaptation and disaster risk reduction*. (Gjinia, përshtatja dhe zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë). Gjendet (në gjuhën angleze) në: <https://www.undp.org/publications/gender-adaptation-and-disaster-risk-reduction>

4.1. Analiza gjinore

Analiza gjinore⁶⁸ ofron të dhënat dhe informacionin e nevojshëm për integrimin gjinor në politika, programe dhe projekte. Si procesi që përbën pikënisjen për integrimin gjinor, analiza gjinore identifikon dallimet ndërmjet dhe në radhët e grave/vajzave dhe burrave/djemve për sa i përket pozicionit të tyre relativ në shoqëri dhe shpërndarjes së burimeve, mundësive, kufizimeve dhe pushtetit në një kontekst të caktuar. Në këtë mënyrë, kryerja e analizës gjinore bën të mundur zhvillimin e ndërhyrjeve të mëtejshme që trajtojnë siç duhet pabarazitë gjinore dhe plotësojnë nevojat e ndryshme të grave/vajzave dhe burrave/djemve. Qëllimi i analizës gjinore është të identifikojë dhe të trajtojë pabarazitë gjinore, përmes:

- pranimit të ekzistencës së dallimeve ndërmjet dhe në radhët e grave/vajzave dhe burrave/djemve bazuar në shpërndarjen e pabarabartë të burimeve, mundësive, kufizimeve dhe pushtetit;
- sigurimit që nevojat e ndryshme të grave/vajzave dhe burrave/djemve janë identifikuar dhe trajtuar qartë në të gjitha fazat e ciklit të politikave;
- pranimit se politikat, programet dhe projektet kanë ndikim të ndryshëm tek gratë/vajzat dhe burrat /djemtë;
- kërkimit dhe formulimit të mendimeve të grave/vajzave dhe burrave/djemve dhe përfshirjes së kontributeve të tyre si komponentë të rëndësishëm në zhvillimin e politikave, programeve dhe projekteve;
- nxitjes së pjesëmarrjes dhe përfshirjes së grave në jetën e komunitetit, jetën politike dhe ekonomike;
- mbështetjes së ndërhyrjeve më të informuara, të efektshme dhe të përgjigjshme gjinore.

Analiza gjinore përfshin marrjen parasysh të përvojave, roleve dhe përgjegjësi të veçanta të grave, dhe shkallën e aksesit të tyre në burime dhe në vendimmarrje. Analiza gjinore përfshin gjithashtu njohjen e pabarazive historike dhe shoqërore me të cilat përballen gratë/vajzat dhe synon të shërbejë si informacion bazë për hartimin e politikave, programeve dhe projekteve që trajtojnë – dhe i ndreqin – këto pabarazi.

68 Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) [në internet]. *Gender Mainstreaming - More Tools and Methods: Gender analysis*. (Integrimi gjinor - Më shumë mjete dhe metoda: Analiza gjinore). Shih: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/methods-tools/gender-analysis#:~:text=As%20a%20starting%20point%20for,power%20in%20a%20given%20context>

Kryerja e një analize gjinore të thelluar dhe të gjithanshme bën të mundur që politikëbërëset/ politikëbërësit të kuptojnë pabarazitë gjinore në një kontekst apo sektor të caktuar: ajo bën përshkrimin e stadi aktual të situatave kontekstuale sipas gjinisë, si edhe shqyrton shkaqet dhe pasojat e dallimeve gjinore në grupin e synuar. Shqyrtimi i arsyeve që qëndrojnë në themel të pabarazive dhe diskriminimit gjinor ndihmon në përcaktimin e objektivave dhe masave përkatëse të fokusuara për eliminimin e pabarazive gjinore. Në këtë mënyrë, analiza gjinore kontribuon në përmirësimin e përgjigjshmërisë gjinore të politikave dhe legjislacionit, sepse ofron bazën për të siguruar trajtimin e duhur të nevojave të të gjitha/gjithë qytetarëve/qytetarëve: grave, burrave, vajzave dhe djemve.

Analiza gjinore është një pjesë integrale e vlerësimit të kushteve sociale menjëherë pas një fatkeqësie me qëllim të qartë për të përmirësuar barazinë dhe drejtësinë gjinore në komunitetet e prekura. Të dhënat dhe rezultatet futen menjëherë në planet e rindërtimit pas katastrofës për të siguruar rezultate të barabarta në rivendosjen dhe forcimin e jetesës së grave dhe burrave. Për shembull, në Shqipëri, pas tërmetit të vitit 2019, UN Women ndërmori një analizë gjinore për të identifikuar fushat kryesore të ndërhyrjeve për një program rikuperimi të përgjigjshëm gjinor, i cili - ndër të tjera - trajton dhunën ndaj grave në zonat e prekura nga tërmeti. Sipas programit, ndihma ligjore dhe shërbime të tjera iu ofruan grave në nevojë dhe ofruesit e shërbimeve u trajnuan për t'iu përgjigjur dhunës në situata krize. Përveç kësaj, programi mbështeti gratë me mundësi jetese dhe sipërmarrjeje. Ai gjithashtu u angazhua në avokim për të siguruar që gratë të regjistrohen si bashkëpronare të shtëpive të reja të ndërtuara në kuadër të programit të rindërtimit të qeverisë, në përputhje me legjislacionin shqiptar.⁶⁹

4.2. Statistikat gjinore mbi ZRRF, mjedisin dhe ndryshimet klimatike në kontekstin shqiptar

Statistikat gjinore përshkruajnë ose matin pabarazitë gjinore. Ato mbështeten në të dhëna për individët, të ndara sipas seksit, pra të dhëna që mblidhen dhe kategorizohen veçmas për gratë/vajzat dhe burrat /djemtë. Këto të dhëna të ndara sipas seksit pasqyrojnë realitetet e jetës së grave/vajzave dhe burrave/djemve, si dhe çështje të politikave që lidhen me gjininë. Ato bëjnë të mundur matjen e dallimeve ndërmjet grave dhe burrave në aspekte të ndryshme shoqërore dhe ekonomike dhe janë të domosdoshme për sigurimin

⁶⁹ Shih: <https://albania.unwomen.org/en/news-and-events/stories/2020/10/increasing-women-resilience-in-post-earthquake-and-pandemic-recovery-in-albania>

e statistikave gjinore. Për të monitoruar përparimin faktik në fushën e barazisë gjinore, konceptet, përkufizimet dhe metodat e përdorura në prodhimin dhe analizimin e të dhënave duhet të bëhen në mënyrë të tillë që të pasqyrojnë rolet, marrëdhëniet dhe pabarazitë gjinore në shoqëri.⁷⁰

Në Shqipëri, statistikat gjinore botohen çdo vit, përmes publikimit të posaçëm të INSTAT-it për këtë qëllim me titull “Gra dhe Burra në Shqipëri”.⁷¹ Objektivi kryesor i këtij botimi është që të vërë në dispozicion të dhëna të ndara sipas seksit dhe statistika gjinore për të mundësuar monitorimin e politikave ndërsektoriale në kuadër të arritjes së objektivave të barazisë gjinore dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Në botim përfshihen jo vetëm të dhëna administrative, por edhe të dhëna të bazuara në vërtetimet sociale që kryen INSTAT-i në nivelin e njësive familjare.

Përpjekjet e INSTAT-it për harmonizimin e statistikave gjinore kombëtare me ato të Eurostatit janë një proces i pandërprerë që vazhdon edhe sot. Në vitin 2021, baza e të dhënave e INSTAT-it u ristrukturua në përputhje me metodologjinë dhe bazën e të dhënave të Eurostatit. Të gjitha të dhënat administrative u vlerësuan kundrejt treguesve të Eurostatit, gjithashtu prodhimi i treguesve të vërtetimeve sociale u bë mbi bazën e një metodologjie të njësuar. Megjithatë, për vendosjen e statistikave gjinore për ZRRF, ndryshimet klimatike dhe mjedisin, përpjekjet duhet të rriten.

Për treguesit që lidhen posaçërisht me ZRRF-në dhe ndryshimet klimatike, Komiteti CEDAW rekomandon hartimin e treguesve gjinorë dhe të mekanizmave monitorues të përgjigjshëm gjinorë. Kjo u mundëson shteteve të përcaktojnë nivelin fillestar dhe të matin përparimin e bërë në fusha si pjesëmarrja e grave në nismat për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe ndryshimet klimatike, si dhe në institucionet politike, ekonomike dhe shoqërore. Integrimi dhe harmonizimi me korniza të tjera si UNFCCC-ja, Agjenda për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030, dhe Korniza Sendai, janë thelbësore për sigurimin e një qasjeje konsistente dhe të efektshme për krijimin dhe monitorimin e treguesve kombëtarë.⁷²

70 Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) [Në internet]. *Gender Mainstreaming – More Tools and Methods: Sex-disaggregated data*. (Integrimi gjinor – Më shumë mjete dhe metoda: të dhëna të ndara sipas seksit). Shih: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/tools-methods/sex-disaggregated-data>

71 Shih: <http://www.instat.gov.al/en/themes/demography-and-social-indicators/gender-equality/#tab3>

72 CEDAW (2018). Rekomandimi i përgjithshëm nr. 37 (2018) mbi përmasat gjinore të zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë në kuadër të ndryshimeve klimatike. Shih: <https://www.ohchr.org/en/documents/general-comments-and-recommendations/general-recommendation-no37-2018-gender-related>

Korniza globale e Sendait për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2015-2030 (KS ZRRF) përcakton një grup me 38 tregues për matjen e përparimit në arritjen e objektivave globale dhe për identifikimin e tendencave globale për zvogëlimin e rrezikut dhe humbjeve. Megjithatë, kjo listë ende nuk e përfshin gjininë si nivel të ndarjes së statistikave. Për ta korrigjuar këtë situatë, institucione si UN ESCAP (Komisioni Ekonomik dhe Social për shtetet e Azisë dhe të Paqësorit i Kombeve të Bashkuara), IUCN (Bashkimi Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës), UNEP (Programi i Mjedisit i Kombeve të Bashkuara) dhe UN Women filluan të punonin së bashku për përmirësimin dhe formulimin e treguesve. Ndër të tjera, u përcaktua që Anketat Demografike dhe të Shëndetit (ADSH) dhe Vrojtimi i Grupeve me Tregues të Shumëfishtë (VGTSH) mund të shërbenin si burim i përshtatshëm për identifikimin e dallimeve brenda familjeve dhe për të mbledhur të dhënat specifike gjinore në nivelin e individëve. Për më tepër, u mor në konsideratë përafrimi midis 38 treguesve të KS-ZRRF-së, treguesve përkatës të OZHQ-ve, si dhe objektivave dhe treguesve të tjerë ekzistues që kërkojnë raportim me të dhëna të ndara sipas seksit, moshës, të ardhurave dhe aftësisë së kufizuar.

Për ndryshimet klimatike dhe fatkeqësitë, janë propozuar këta tregues me ndjeshmëri gjinore⁷³:

- BGJ 15 (GE15): Numri i vdekjeve, personave të humbur dhe personave të prekur drejtpërdrejt nga fatkeqësitë hidrometeorologjike për 100,000 banorë, të ndarë sipas seksit (i ngjashëm me treguesit 1.5.1, 11.5.1, dhe 13.1.1 të OZHQ-ve).
- BGJ 16 (GE16): Numri i personave të cilëve u janë dëmtuar banesat si pasojë e fatkeqësive, ndarë sipas seksit (i ngjashëm me treguesin B-3 të Sendait).
- BGJ 17 (GE17): Numri i personave të cilëve iu vështirësua fitimi i jetesës ose iu shkatërruan mjetet e jetesës si pasojë e fatkeqësive, ndarë sipas seksit (i ngjashëm me treguesin B-5 të Sendait).

73 Puna e sekretariatit dhe partnerëve për integrimin e perspektivës gjinore në statistikat mjedisore, sesioni i shtatë i Komitetit të Statistikave të ESCAP-it, Bangkok, 26-28 gusht 2020, Pika 3 (b) e agjendës së përkohshme 'Advancing official statistics for the 2030 Agenda for Sustainable Development: initiatives by global, regional and subregional organizations in support of the collective vision and framework for action'. ('Forcimi i statistikave zyrtare për Agjendën e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030: nisma nga organizata globale, rajonale dhe nënrajonale në mbështetje të një vizioni dhe kuadri veprimi kolektiv'). Shih: <https://www.unescap.org/events/committee-statistics-seventh-session>

Një rezultat tjetër i bashkëpunimit ndërmjet UN ESCAP, IUCN, UNEP, UN Women, dhe partnerëve të tjerë të angazhuar në këtë fushë ishte edhe hartimi i pyetësorit model të Qendrës së të Dhënave të UN Women.⁷⁴ Ky mjet mbështet vendet në ndërmarrjen e anketave të ndjeshme gjinore të mjedisit, gjë që mundëson llogaritjen e treguesve gjinorë të mësipërm. Ky pyetësor mund të përdoret si anketë e pavarur, ose të përfshihet si modul në kuadër të anketave të tjera të planifikuara. Ai është i përshtatshëm për çdo anketim të familjeve që përpilon informacion në nivelin e individit dhe që i bën pyetje të veçanta të paktën një anëtarit dhe një anëtareje (në moshë të rritur) në secilën familje. Nëse përdoret i plotë, pyetësori kthen të dhëna për më shumë se 200 tregues konkretisht në lidhjen gjini-mjedis.

Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP) III i BE-së përmban një listë të konsiderueshme të treguesve të ndjeshëm gjinorë në fushën e ndryshimeve klimatike dhe mjedisit, përfshirë edhe në fushën e zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë. Në përgjithësi, monitorimi i këtyre treguesve është ende në një fazë shumë të hershme dhe formulimi dhe metodologjia e treguesve gjinorë duhet të përmirësohen më tej. Nevojiten përpjekje të posaçme nga zyrat e statistikave, ministritë e mjedisit dhe agjencitë kombëtare të ngarkuara me mbrojtjen civile për të identifikuar burimet e të dhënave në nivel kombëtar, për të identifikuar treguesit e tërthortë, për të përpiluar metadata, dhe për të mbështetur mbledhjen e të dhënave përkatëse.

4.3. Vlerësimi i ndikimit gjinor

Vlerësimi i ndikimit gjinor është një metodë e standardizuar e BE-së që përdoret rregullisht për vlerësimin *ex ante* të dokumenteve ligjore, planeve të politikave strategjike dhe programeve në proces zbatimi.⁷⁵ Një përdorim më i gjerë i vlerësimit të ndikimit gjinor i ndihmon politikëbërësit/politikëbërësit dhe nëpunëset/nëpunësit publikë që të analizojnë dhe parashikojnë ndikimin që do të ketë tek gratë/vajzat dhe burrat/djemtë çfarëdo vendimi i rëndësishëm që shqyrtohet prej tyre, gjë që do të ndihmojë në përmirësimin e masave

74 UN Women Data Hub (2022). *Model questionnaire: Measuring the nexus between gender and the environment*. (Model pyetësori: matja e lidhjes ndërmjet gjinisë dhe mjedisit). Shih: <https://data.unwomen.org/publications/model-questionnaire-measuring-nexus-between-gender-and-environment>

75 Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) [Në internet]. *Gender Mainstreaming – More Tools and Methods: Gender Impact Assessment*. (Integrimi gjinor – më shumë mjete dhe metoda: Vlerësimi i ndikimit gjinor). Shih: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/toolkits/gender-impact-assessment/what-gender-impact-assessment>

ekzistuese dhe do të shërbejë si bazë për marrjen e vendimeve për alokimin e buxheteve. Përfundimet e nxjerra nga çdo vlerësim i ndikimit gjinor duhet të vihen në dispozicion në kohë, në mënyrë që të bëhet i mundur ndryshimi i akteve ligjore dhe politikave të tjera përkatëse gjatë fazave të hartimit dhe planifikimit.

“Vlerësimi i ndikimit gjinor mund të kryhet për aktet legislative, planet e politikave, programet e politikave, buxhetet, veprimet konkrete, projektligjet dhe raportet apo angazhimet për punë kërkimore shkencore. Metodatat e vlerësimit të ndikimit gjinor duhet të zbatohen jo vetëm për politikën që janë në fazën e hartimit; ato mund të zbatohen edhe në kuadër të politikave tashmë ekzistuese. Ato mund të përdoren si në administratë, ashtu edhe nga aktorë të jashtëm; në të dy rastet ato kërkojnë një sasi të konsiderueshme njohurish lidhur me çështjet gjinore.”⁷⁶

Kohët e fundit, në kuadër të Projektit SANECA të administruar nga GIZ-i, instrumenti i Vlerësimit të Ndikimit Gjinor *ex ante* të BE-së u përshtat për kontekstin shqiptar, me fokus të veçantë mbi përfshirjen e objektivave të barazisë gjinore në të ashtuquajturit “kapitujt e tregut të brendshëm” të BE-së (pra kapitujt 1, 3, 20 dhe 28).⁷⁷ Në Kosovë, Agjencia për Barazi Gjinore – që operon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit – përgatiti në vitin 2019 një Manual të posaçëm për Vlerësimin e Ndikimit Gjinor me mbështetjen financiare të Suedisë.⁷⁸

4.4. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor në kuadër të ndryshimeve klimatike dhe ZRRF-së

Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor (BPGJ) është një proces kryesor për përfshirjen e këndvështrimit gjinor në planifikim. Ai “synon të sigurojë që mbledhja dhe alokimi i burimeve publike të kryhet në mënyra të cilat janë efektive dhe

76 Këshilli i Evropës (2004). *Gender mainstreaming: Conceptual framework, methodology and presentation of good practices*. (Integrimi gjinor: korniza konceptuale, metodologjia dhe prezantimi i praktikave të mira). Shih: <https://rm.coe.int/1680596135>

77 GIZ (2022). *Gender Mainstreaming in the Internal Market Chapters of the Acquis - Guidelines and Tools*. (Integrimi gjinor në kapitujt e tregut të brendshëm të *acquis* – Udhëzime dhe mjete). Shih: https://pubhtml5.com/qzcc/xxqq/Gender_Mainstreaming_in_the_Internal_Market_Chapters_of_the_Acquis/3

78 Republika e Kosovës Agjencia për Barazinë Gjinore (2019). Manuali i Vlerësimit të Ndikimit Gjinor. Shih: <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABCJ/Gender%20Equality%20Impact%20Assessment%20Manual.pdf>

kontribuojnë për të çuar përpara barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave.”⁷⁹ Është e rëndësishme të theksohet që buxhetim i përgjigjshëm gjinor nuk do të thotë që të krijohet një buxhet i veçantë për gratë, e as që thjesht të shtohen fondet e shpenzuara në programet për gratë. Shembuj se si mund të zbatohet buxhetimi i përgjigjshëm gjinor krahas integritit gjinor në një fushë/sector të politikave janë⁸⁰:

- ☑ Hartimi i objektivave dhe aktiviteteve për trajtimin e hendeqeve gjinore të identifikuar dhe përfshirja e tyre në dokumente strategjike, korniza logjike, marrëveshje financiare dhe buxhete.
- ☑ Alokimi i burimeve për rritjen e ndërgjegjësimit gjinor dhe fuqizimin e kapaciteteve në fushën e integritit gjinor në të gjitha nivelet dhe në mënyra që përshtaten me nevojat e grupeve të ndryshme të synuara, si në radhët e politikëbërëseve/politikëbërësve, punonjëseve/punonjësve të programeve, grave dhe burrave përfituese/përfitues nga programet, personelit të institucioneve përkatëse vendore, institucioneve që ofrojnë shërbime, si dhe grave/vajzave/burrave/djemve nga komunitetet e pafavorizuara.
- ☑ Projektimi dhe përcaktimi i buxheteve për procese monitoruese me pjesëmarrje dhe me ndjeshmëri gjinore.
- ☑ Gjatë sigurimit të fondeve për zbatimin e veprimeve të përgjigjshme gjinore për përshtatjen me ndryshimet klimatike, të merret në shqyrtim mundësia e angazhimit të sektorit privat në veprimet lidhur me ndryshimet klimatike dhe gjininë.

Në varësi nga shkalla në të cilën një vend i caktuar ka përfshirë aspektet e përshtatjes me ndryshimet klimatike në buxhete, buxhetimi i përgjigjshëm gjinor mund të zbatohet në nivelin e buxhetit të përgjithshëm të vendit, të ministrisë, apo të autoriteteve vendore. Nëse integrimi i aspekteve të përshtatjes është ende në kryerje e sipër, atëherë procesi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor mund të ndërmerret në lidhje me financime të caktuara

79 UN Women Azi dhe Paqësor [në internet]. “*Gender Responsive Budgeting*. (Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor). Gjendet në: <https://asiapacific.unwomen.org/en/focus-areas/women-poverty-economics/gender-responsive-budgeting>

80 Komisioni Evropian (2020). “*Thematic Brief: Gender and climate change and disaster risk reduction*” (Dosje tematike: gjinia dhe ndryshimet klimatike dhe zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë); NAP Global Network (2021). *Advancing Gender-Responsive Climate Action Through National Adaptation Plan (NAP) Processes*. [Forcimi i veprimeve klimatike me përgjigjshmëri gjinore përmes proceseve të planeve kombëtare të përshtatjes (PKP)].

ose programe që kanë të bëjnë me përshtatjen me ndryshimet klimatike. Kjo mund të përfshijë veprime si (i) rishikimi i analizave gjinore dhe përparësive të përshtatjes të identifikuar në planet kombëtare të veprimit për të përcaktuar nevojat e diferencuara gjinore; (ii) ndërmarrja e një vlerësimi të ndikimit gjinor të buxheteve; dhe (iii) rishikimi me lente gjinore i shpenzimeve për përshtatjen me ndryshimet klimatike.⁸¹

4.5. Prokurimi publik i përgjigjshëm gjinor

Prokurimi publik i përgjigjshëm gjinor (PPPGJ) është prokurim që nxit barazinë gjinore përmes blerjes së mallrave, shërbimeve apo punimeve. Kjo do të thotë që blerëset/blerësit dhe ofrueset/ofruesit e shërbimeve duhet (i) të analizojnë ndikimin që kanë të gjitha veprimtaritë e kontraktuara mbi nevojat, interesat dhe shqetësimet e grave dhe burrave; dhe (ii) të hartojnë dhe t'i realizojnë kontratat në mënyrë të tillë që redukton pabarazitë. PPPGJ-ja nuk nënkupton domosdoshmërisht shpenzime më të mëdha, por kërkon njohuri dhe kapacitete.⁸²

Prokurimi publik dhe akordimi i kontratave kompanive private që punësojnë fuqi punëtore nga jashtë kompanisë mund të sjellë ndikim pozitiv në rritjen e punësimit në nivel vendor në përgjithësi, dhe në mundësitë e punësimit të grave në veçanti. Në ftesat për propozime që u paraqiten programeve financuese ose në termat e referencës të procedurave të prokurimit publik – ndër të cilat edhe ato për kontraktorët që do të angazhohen për shërbimet në mbështetje të politikave – mund të përfshihen klauzola që përmendin produktet sociale që synohet të arrihen (për shembull, përqindja e punëtoreve/punëtorëve vendas të kontraktuar sipas kategorisë; përqindja e grave që do të punësohen; detyrimi për të reduktuar pabarazitë gjinore; respektimi i parimeve të barazisë gjinore, dhe të tjera të ngjashme). Kjo do të sigurojë që projektet dhe shërbimet që marrin fonde të kenë përfshirë kapacitetet gjinore, t'u përgjigjen nevojave të ndryshme të grave/vajzave/burrave/djemve, si dhe të kontribuojnë në arritjen e barazisë gjinore.

81 NAP Global Network & UNFCCC (2019). *Toolkit for a gender-responsive process to formulate and implement National Adaptation Plans (NAPs)*. [Paketë mjetesh për një proces të përgjigjshëm gjinor për formulimin dhe zbatimin e planeve kombëtare të përshtatjes (PKP-ve)]. Gjetet në: <https://napglobalnetwork.org/resource/toolkit-for-gender-responsive-national-adaptation-plans/>

82 Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) [Online]. *Gender Mainstreaming - More Tools and Methods: Gender-responsive public procurement*. (Integrimi gjinor - Më shumë mjete dhe metoda: prokurim publik i përgjigjshëm gjinor). Shih: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/methods-tools/gender-responsive-public-procurement>

Komisioni Evropian thekson shprehimisht në Strategjinë e tij për Barazinë Gjinore 2020-2025 se “Udhëzimi i Komisionit për prokurimin publik të përgjigjshëm social do të luftojë diskriminimin dhe do të promovojnë barazinë gjinore në tenderat publikë”.⁸³ Si një ndër produktet e para të Strategjisë, Komisioni ka propozuar masa të detyrueshme për transparencën në paga, në përputhje me projekt-direktivën mbi transparencën në paga, që trajton specifikisht pagën e barabartë dhe hendekun në paga në kontekstin e prokurimit publik (në nenin 21). Më 24 prill 2023, Këshilli Evropian miratoi rregulla të reja për transparencën e pagës përmes **Direktivës së Transparencës së Pagës**. Sipas rregullave të reja, kompanive të BE-së u kërkohet të ndajnë informacione për pagat dhe të ndërmarrin veprime, nëse hendeku gjinor në paga i tejkalon pesë për qind. Direktiva përfshin gjithashtu dispozita për kompensimin për viktimat e diskriminimit në paga, si dhe dënime përfshirë gjrobat, për punëdhënësit që thyejnë rregullat.⁸⁴

Shembuj të tjerë të PPPGJ-së përfshijnë p.sh., Zvicrën, ku çdo kompanie që bën biznes me qeverinë i kërkohet të paguajë burrat dhe gratë e stafit në mënyrë të barabartë. Në Spanjë, Ligji i Prokurimit Publik përfshin klauzola të ndryshme të barazisë gjinore, që u referohen fazave të ndryshme të procedurës së prokurimit, nga përzgjedhja e kontraktorit deri te ekzekutimi i kontratave publike. Kushdo me një dënim për shkeljen e të drejtave të punëtorëve/punëtorëve, duke përfshirë çdo sjellje që shkel të drejtat dhe mundësitë e grave - të tilla si diskriminimi ose ngacmimi - nuk ka të drejtë të nënshkruajë kontrata me institucionet e sektorit publik. Kompanitë me më shumë se 250 punonjëse/punonjës që nuk kanë zbatuar plane për barazinë gjinore gjithashtu ndalohen të marrin pjesë në kontraktimin përmes prokurimit publik.⁸⁵

UN Women promovon metoda të tjera që gratë të përfitojnë nga ekonomia, të tilla si (i) rregullat e prokurimit që u japin përparësi ofertave nga bizneset në pronësi të grave; dhe (ii) promovimin e kompanive përtej biznesit të ciklit të

83 *Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions – A Union of equality: Gender equality strategy 2020–2025, COM(2020) 152, 5.3.2020.* (Komunikimi i Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve - Një Bashkim i barazisë: Strategjia për barazinë gjinore 2020–2025, COM(2020) 152, 5.3.2020). Gjetendet në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52020DC0152>

84 DIREKTIVA E PARLAMENTIT DHE E KËSHILLIT EVROPIAN për të forcuar zbatimin e parimit të pagës së barabartë për punë të barabartë ose punë me vlerë të barabartë midis burrave dhe grave nëpërmjet transparencës së pagave dhe mekanizmave të zbatimit, 2021/0005(COD), 11 prill 2021. Shih: <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/PE-81-2022-INIT/en/pdf>

85 UNODC (2020). *The Time Is Now: Addressing the Gender Dimensions of Corruption*. (Koha është tani: Adresimi i dimensioneve gjinore të korrupsionit). Shih: https://www.unodc.org/documents/corruption/Publications/2020/THE_TIME_IS_NOW_2020_12_08.pdf

përbashkët, duke zgjeruar kështu spektrin e mundësive të punësimit dhe duke krijuar tregje të reja.⁸⁶

Për udhëzime të hollësishme të BE-së mbi PPPGJ-në, shih: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/methods-tools/gender-responsive-public-procurement>.

4.6. Monitorimi dhe vlerësimi i ndjeshëm gjinor

Monitorimi dhe vlerësimi i ndjeshëm gjinor përdoret për të treguar nëse në një program të caktuar trajtohen përparësitë dhe nevojat e ndryshme të grave/vajzave dhe burrave/djemve. Qëllimi është të vlerësohet nëse programi ka ndikimin e parashikuar (ose edhe ndonjë ndikim të paparashikuar) në marrëdhëniet gjinore dhe të përcaktohen aspektet gjinore që duhen integruar në sistemet e monitorimit dhe të vlerësimit. Një monitorim dhe vlerësimi i ndjeshëm gjinor që është efektiv duhet të përfshijë si të dhëna cilësore ashtu edhe sasiore që matin ndikimin mbi marrëdhëniet midis gjinive. Pa të dhëna të mjaftueshme është shumë e vështirë të bëhet një analizë e plotë e ndikimit të programeve mbi barazinë gjinore. Kjo do të thotë që të gjitha të dhënat duhet të mblidhen, paraqiten dhe analizohen më së paku të ndara sipas seksit.⁸⁷ Gjithashtu, rezultatet dhe informacionet e marra nga monitorimi dhe vlerësimi i ndjeshëm gjinor shërbejnë si bazë për ciklet e politikave: ato identifikojnë aspektet për të cilat do të duhet të përfshihen objektiva dhe tregues të barazisë gjinore të formuluar shprehimisht në fazën e planifikimit.

Kornizat e monitorimit dhe vlerësimit (M&E) të përshtatjes me ndryshimet klimatike përgjithësisht vazhdojnë të jenë një fushë që paraqet vështirësi, por me ndërmarrjen e një numri veprimesh mund të bëhet e mundur që në sistemet e M&E në kuadër të proceseve kombëtare të përshtatjes të përfshihen me efektivitet konsideratat gjinore. Si pikënisje, përfshirja e aktorëve gjinorë në hartimin e kornizave të M&E mund të ndihmojë në trajtimin e çështjeve kryesore dhe punën e mëtejshme mbi të dhënat ekzistuese. Në treguesit e përparimit në lidhje me proceset e përshtatjes duhet të përfshihen tregues të barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave, ndërsa kornizat vlerësuese duhet

86 UN Women (2017). *The Power of Procurement: how to source from women-owned business*. (Fuqia e Prokurimit: si të sigurohet nga biznesi në pronësi të grave). Shih: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2017/3/the-power-of-procurement>

87 Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) *Thesaurus*. (Fjalor tematik) [në internet]. Gjetet (në gjuhën angleze) në: <https://eige.europa.eu/thesaurus/terms/1217?lang=en>

të analizojnë si cenueshmëritë e ndryshme gjinore, ashtu edhe ndikimin që kanë veprimet e përshtatjes mbi gratë, burrat, personat që nuk e kategorizojnë veten si djem/burra apo vajza/gra, si dhe gratë dhe burrat nga grupet e pafavorizuara. Së fundi, mbledhja e të dhënave të ndara sipas seksit ka rëndësi thelbësore për kryerjen e vlerësimeve të diferencuara të cenueshmërive, për kryerjen e analizave gjinore dhe evidentimin e barazisë së pjesëmarrjes në investimet për përshtatjen me kushtet klimatike dhe të rezultateve të arritura prej tyre.⁸⁸

88 NAP Global Network and UNFCCC. (2019). *Toolkit for a gender-responsive process to formulate and implement National Adaptation Plans (NAPs)*. [Paketë mjetesh për një proces të përgjigjshëm gjinor për formulimin dhe zbatimin e planeve kombëtare të përshtatjes (PKP-ve)]. Gjetet në: <https://napglobalnetwork.org/resource/toolkit-for-gender-responsive-national-adaptation-plans/>

5 REKOMANDIME TË RËNDËSISHME PËR ZRRF-NË DHE VEPRIMET E LIDHURA ME MJEDISIN DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

Ndërhyrjet për integrimin gjinor përfshijnë ngritjen e kapaciteteve për kryerjen e analizave gjinore, si dhe angazhimin aktiv të specialisteve/specialistëve të integritit gjinor përgjatë të gjithë fazave të hartimit, zbatimit dhe monitorimit të strategjive dhe politikave. Për më tepër, politikat ekzistuese në zbatim e sipër duhet të shqyrtohen lidhur me përgjigjshmërinë e tyre gjinore (pra, të vlerësohet si i trajtojnë ato pabarazitë gjinore në sektorin/fushën e politikës). Nëse është e nevojshme, këto politika duhet të rishikohen, me qëllim integrimin gjinor në strategjitë sektoriale dhe në strukturat, sistemet dhe proceset e të gjitha institucioneve të përfshira.

TABELA 3

Veprime prioritare për integrimin e objektivave të barazisë gjinore në ZRRF, dhe veprime të tjera që lidhen me mjedisin dhe ndryshimet klimatike⁸⁹

Çështja kryesore gjinore	Veprimet prioritare
<p>Gratë përballen me pasoja më të drejtpërdrejta nga fatkeqësitë</p> <p>...</p>	<ul style="list-style-type: none"> <input checked="" type="checkbox"/> Gjatë emergjencave, të sigurohet që infrastruktura dhe shërbimet kritike të jenë të disponueshme, aksesueshme dhe përshtatshme edhe nga pikëpamja kulturore për të gjitha gratë dhe vajzat, mbi bazën e barazisë. <input checked="" type="checkbox"/> Pas fatkeqësive, të sigurohet zvogëlimi i menjëhershëm i rreziqeve të mëtejshme, ndër të tjera edhe përmes masave për parandalimin e dhunës me bazë gjinore në strehëza/kampe (p.sh., përmes përmirësimit të mureve rrethuese të jashtme, ndarjes së mjediseve brenda ndërtesave, dhe sigurimit të dyerve që mund të kyçen për më shumë siguri dhe privatësi, sidomos në strehëzat kolektive, vendosja e banjave në vende të sigurta dhe të ndriçuara mirë, ofrimi i ndriçimit dhe sigurisë së mjaftueshme në mjedise dhe rreth tyre). <input checked="" type="checkbox"/> Mbështetja e së drejtës së grave për (bashkë)pronësi dhe kontroll mbi burimet strategjike, si banesa dhe toka.

⁸⁹ Rekomandimet bazohen në ato që janë paraqitur në materiale të ndryshme burimore, ndër të cilat: *ITC ILO Gender, Climate Change and Disaster Risk Reduction - Thematic Brief*. (Gjinia, ndryshimet klimatike dhe zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë – Dosje tematike); Kavasa D. & D.E. Giuli (2014), *Gender Guidance Note on Energy and Environment in the Eastern Neighbourhood*. (Shënim udhëzues gjinor mbi energjinë dhe mjedisin në rajonin lindor); EIGE (2016), *Gender in environment and climate change*. (Gjinia në kontekstin e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike); Këshilli i Ministrave (2020), Vlerësimi i nevojave pas fatkeqësive në Shqipëri; *CEDAW General Comment No.37 on Gender-related dimensions of disaster risk reduction in the context of climate change, 2018*. (Komenti i përgjithshëm nr. 37 i CEDAW mbi përmasat gjinore të zvogëlimin të rrezikut nga fatkeqësitë në kontekstin e ndryshimeve klimatike), 2018; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, GEF dhe UNDP (2021), Raporti i parë dyvjeçar i përditësuar për Shqipërinë për Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike (UNFCCC); Plani i rishikuar i veprimit për kontributin kombëtar të pikësnyuar (KKP) për Shqipërinë (2021); NAPs Global Network (2021) (Rrjeti Global i PKP-ve) (2021), *Advancing Gender-Responsive Climate Action Through National Adaptation Plan (NAP) Processes*. [Forcimi i veprimit klimatik me përgjigjshmëri gjinore përmes proceseve të planeve kombëtare të përshtatjes (PKP-ve)]; UN ECOSOC (2022), *Commission on the Status of Women, Sixty-sixth session, 14-25 March 2022, Achieving gender equality and the empowerment of all women and girls in the context of climate change, environmental and disaster risk reduction policies and programmes: agreed conclusions*. (Komisioni për Statusin e Grave, Sesioni i 66-të, 14-25 mars 2022. Arritja e barazisë gjinore dhe forcimi i të gjitha grave dhe vajzave në kontekstin e ndryshimeve klimatike, politikave dhe programeve mjedisore dhe të zvogëlimin të rrezikut nga fatkeqësitë: përfundimet e miratuara); dhe UNDRR (2023), *A Review of Gender and the Sendai Framework*. (Një rishikim i gjinisë dhe Kornizës Sendai).

...	<ul style="list-style-type: none"> ☑ Të sigurohet zbatimi në vijimësi i rekomandimeve gjinore të paraqitura në “Vlerësimin e Nevojave pas Fatkeqësive” (VNPF), të kryer nga ekipi i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri. ☑ Të ndërmerret një analizë gjinore dhe vlerësim i ndikimit gjinor përpara rindërtimit të shtëpive dhe infrastrukturës, për të siguruar marrjen parasysh të nevojave dhe prioriteteve të ndryshme të grave dhe burrave që nga faza e projektimit e deri tek ajo e ndërtimit. ☑ Të sigurohet transparencë në shpërndarjen e fondeve të rimëkëmbjes, sidomos kur ato shpërndahen në formën e parasë, dhe të sigurohet që burimet t’u shpërndahen grave dhe burrave në mënyrë të barabartë. ☑ Gratë të kompensohen për ngarkesën shtesë të punës së papaguar që kryejnë në periudhën pas fatkeqësisë (p.sh. pas tërmetit). ☑ T’u jepen ndihma posaçërisht grave për zëvendësimin e pajisjeve dhe orendive shtëpiake, sepse ato lidhen me punët që kryejnë gratë në shtëpi, veprimtaritë e tyre sipërmarrëse nga shtëpia, dhe me veprimtari të tjera për gjenerimin e të ardhurave. ☑ Të krijohen fonde të posaçme për rifillimin e shpejtë të punës në ndërmarrjet e vogla dhe veprimtaritë sipërmarrëse që gratë kryejnë nga shtëpia. ☑ T’u jepet prioritet rimëkëmbjes së shërbimeve shkollore, sociale dhe të fëmijëve, si dhe shtëpive të sigurta, për të siguruar që gratë të mos e ndërpresin punësimin. ☑ Pas çdo fatkeqësie, të maksimizohen mundësitë për përmirësimin e kushteve sociale, d.m.th. të përmirësohen barazia dhe drejtësia gjinore. ☑ Të përdoret faza e rindërtimit pas fatkeqësive për rikrijimin e mundësive të fitimit të jetesës nga gratë dhe burrat dhe të forcohet aftësia ripërtëritëse e komuniteteve. ☑ Të mundësohet akses i grave në produktet financiare që mund të kenë nevojë për rivendosjen e mjeteve të tyre të jetesës, si p.sh. përmes rregullimeve të kriterëve dhe kërkesave të përshtatshme.
-----	--

<p>...</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☑ Të sigurohet pjesëmarrja e grave dhe burrave në diskutimet publike për ndërgjegjësimin mjedisor, ndryshimet klimatike, dhe ZRRF-në përmes përfshirjes dhe konsultimeve me shoqërinë civile dhe organizatat e grave.
<p>Kornizat e zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë nuk i trajtojnë pabarazitë gjinore në mënyrë të vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse</p> <p>...</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☑ Të rriten kapacitetet dhe aftësitë e të gjithë individëve të përfshirë në hartimin e kornizave të ZRRF-së dhe përshtatjes, për integrimin gjinor, duke përdorur udhëzime ndërkombëtare të disponueshme publikisht dhe duke kryer trajnime të dedikuara. ☑ Të mbledhen dhe përdoren të dhëna (sasiore dhe cilësore) mbi natyrën gjinore të rrezikut nga fatkeqësitë dhe se si pabarazia gjinore është një nxitës rreziku që mund të zvogëlohet përmes programeve dhe veprimeve të përgjigjshme gjinore të ZRRF-së, duke përfshirë vlerësimet e rrezikut dhe vlerësimet e nevojave. ☑ Të pajisen mekanizmat kombëtarë të barazisë gjinore dhe subjektet përgjegjëse në fushën e ndryshimeve klimatike, mjedisit, si dhe menaxhimit dhe zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë, me burime të përshtatshme njerëzore dhe financiare për të siguruar integrimin gjinor në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave, programeve dhe projekteve përkatëse. ☑ Të planifikohen dhe kryhen vlerësime të ndjeshme gjinore të rrezikut nga fatkeqësitë për analizimin e rreziqeve dhe cenueshmërive me të cilat përballen gratë dhe burrat. ☑ Të përdoren rezultatet e vlerësimeve të ndjeshme gjinore të rrezikut nga fatkeqësitë, si bazë për politikën mbi gatishmërinë për përballimin dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike, si dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë. ☑ Të identifikohen dhe eliminohen të gjitha format e diskriminimit, përfshirë edhe format e shumëfishta e të ndërthurura të diskriminimit ndaj grave, në legjislacionin, politikën, programet, planet dhe aktivitetet përkatëse në nivel kombëtar dhe vendor. ☑ Të integrohen shkaqet dhe pasojat e ndryshimeve klimatike, degradimit të mjedisit dhe zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë, në programet mësimore në të gjitha nivelet.

<p>...</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☑ Të hartohen programe mësimore për aftësitë në shpëtimin e jetëve në rast rreziku me materiale dhe mesazhe të përshtatshme sipas moshës dhe gjinisë, si dhe të pasurohen programet arsimore me mësim, të organizuara në formën e projekteve dhe që venë në qendër fëmijët, mbi gatishmërinë për situatat e fatkeqësive dhe ZRRF-në. ☑ Të krijohen dhe vendosen sisteme të paralajmërimit të hershëm, të aksesueshme në mënyrë të barabartë për gratë dhe burrat në të gjithë vendin, përfshirë edhe në zonat e thella. ☑ Të sigurohet pjesëmarrja efektive e organizatave të grave dhe e drejtuesve të komuniteteve në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e strategjive, politikave dhe legjislatcionit lidhur me ZRRF-në në nivel kombëtar dhe vendor.
<p>Gratë janë më të cenueshme nga ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe të degradimit të mjedisit</p> <p>...</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☑ Të kryhen studime dhe mbledhje të dhënash në të gjithë sektorët për vlerësimin e ndikimit gjinor specifik të ndryshimeve klimatike dhe degradimit të mjedisit mbi gratë dhe burrat. ☑ Të nxitet përdorimi i perspektivës gjinore në mbledhjen e të dhënave dhe informacionit, identifikimin e problemeve dhe formulimin e zgjidhjeve për të siguruar që nevojat e grave dhe burrave njihen, dokumentohen dhe adresohen. ☑ Të trajtohen në mënyrë të vazhdueshme pabarazitë gjinore ekzistuese dhe dallimet ndërmjet grave dhe burrave. ☑ Të sigurohen përfitime të barabarta për gratë dhe burrat nga investimet dhe grantet në kuadër të përshtatjes dhe rimëkëmbjes pas fatkeqësive. ☑ Të ndërtohen dhe forcohen aftësitë ripërtëritëse dhe përshtatëse të të gjitha grave dhe vajzave në kontekstin e ndryshimeve klimatike, degradimit të mjedisit dhe fatkeqësive, përmes financimit dhe sigurimit të infrastrukturës dhe shërbimeve publike të qëndrueshme, mbrojtjes sociale dhe punës së denjë për gratë. ☑ Të forcohen dhe/ose zhvillohen kapacitetet përshtatëse të komuniteteve dhe të sigurohet përdorimi i njohurive të fermerëve dhe fermerëve si një pikë hyrëse e vlefshme në kuadër të përshtatjes së lokalizuar në nivel vendor.

<p>...</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☑ Të trajtohen kufizimet dhe pengesat në punësimin dhe sipërmarrjen e grave në sektorin bujqësor, përdorimin efikas të energjisë dhe gjenerimin e energjisë së pastër, duke marrë parasysh potencialin e qasjeve të bazuara në ekosistem dhe në zgjidhje me bazë natyrore, që ka në qendër mbrojtjen dhe përkujdesin me përgjigjshmëri gjinore dhe përfshirës për të gjitha moshat. ☑ Të përfshihen gratë në seanca trajnimi lidhur me masat përshtatëse dhe të sigurohet që praktikat e promovuara të mos krijojnë një ngarkesë më të madhe fizike për to.
<p>Mungesa e integritit gjinor dhe e zërit të grave në politikat dhe masat mbi ndryshimet klimatike</p> <p>...</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☑ Të nxitet barazia gjinore dhe pjesëmarrja, përfaqësimi dhe roli udhëheqës i grave në të gjitha nivelet e organeve dhe proceseve të vendimmarrjes mbi ndryshimet klimatike, mjedisin dhe zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, si dhe të caktohen objektiva dhe afate të qarta për arritjen e ekuilibrit gjinor. ☑ Të forcohen kapacitetet e institucioneve për integrimin e perspektivës së barazisë gjinore në hartimin dhe zbatimin e ligjeve, politikave dhe programeve mbi përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike, ruajtjen e biodiversitetit, menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, si edhe në vlerësimet e nevojave, sistemet e parashikimit dhe të paralajmërimit të hershëm, dhe planet për parandalimin, gatishmërinë, reagimin, ndihmën, rehabilitimin dhe rindërtimin në raste fatkeqësish. ☑ Të kryhen analiza gjinore në nivel sektorial dhe përfundimet dhe rekomandimet e tyre të pasqyrohen në dokumentet strategjike kombëtare dhe vendore. ☑ Të mbështeten dhe financohen studime dhe analiza gjinore për të përcaktuar lidhjet konkrete midis barazisë gjinore dhe fuqizimit të të gjitha grave dhe vajzave, dhe ndryshimeve klimatike, degradimit të mjedisit dhe fatkeqësive, në mënyrë që ato të shërbejnë si bazë për politikat dhe programet. ☑ Të promovohet buxhetimi i përgjigjshëm gjinor në ZRRF, MRRF, dhe politikat mbi ndryshimet klimatike.

<p>•••</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☑ Të mbliidhen, dokumentohen dhe promovohen praktikat më të mira për trajtimin e çështjeve të barazisë gjinore në fushat e ZRRF-së dhe të ndryshimeve klimatike. ☑ Të hartohet dhe bëhet pilotimi në nivel vendor i projekteve me ndjeshmëri gjinore për përshtatjen me ndryshimet klimatike në fushat e bujqësisë, menaxhimit të pyjeve, përdorimit të tokës dhe energjisë. ☑ Të rritet pjesëmarrja kuptimplotë e grave në rolet drejtuese dhe vendimmarrëse, dhe në një numër të konsiderueshëm, si aktore kryesore në qeverisjen vendore dhe kombëtare, për të siguruar që nevojat dhe interesat e tyre plotësohen, si dhe për të ndihmuar në sigurimin që ZRRF për të gjitha/gjithë të përfitojë nga aksesit në burimet dhe kapacitetet njerëzore më të mira në çdo kontekst. ☑ Të sigurohet pjesëmarrje përfshirëse dhe e barabartë gjinore e të gjithë aktorëve në proceset e përshtatjes, ndër të tjera edhe përmes krijimit të partneriteteve dhe bashkëpunimit me organizatat e të drejtave të grave, si dhe me gratë drejtuese të komuniteteve. ☑ Të angazhohen gratë dhe mbrojtëset/mbrojtësit e të drejtave të grave në procesin e monitorimit të planeve të veprimit që lidhen me Strategjinë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike (SKNK), Planin Kombëtar të Veprimit për Zbutjen e Ndryshimeve Klimatike (PKVZNK) dhe Planin Kombëtar të Përshtatjes (PKP).
------------	--

Mungesa e statistikave gjinore mbi ZRRF-në, ndryshimet klimatike dhe mjedisin

- ☑ Të forcohen kapacitetet e zyrave dhe institucioneve shtetërore që hartojnë statistika/të dhëna, për të mbledhur, analizuar, përhapur dhe përdorur të dhëna dhe statistika mbi ndryshimet klimatike, degradimin e mjedisit dhe fatkeqësitë, përfshirë të dhëna të ndara sipas seksit, moshës, përkatësisë etnike, gjendjes civile, statusit të migrimit, aftësisë së kufizuar, vendndodhjes gjeografike dhe karakteristikave të tjera që kanë lidhje me kontekstin kombëtar.
- ☑ Të identifikohen burimet parësore administrative për të dhënat gjinore që lidhen me ZRRF-në në institucionet përgjegjëse.
- ☑ Të pilotohet pyetëtori model (2022) i *UN Women Data Hub* (Baza Qendrore e të Dhënave e UN Women) në anketimet për matjen e lidhjeve ndërmjet gjinisë dhe mjedisit; dhe si alternativë, të përfshihet pyetëtori model si modul në anketimet e tjera të planifikuara për t'u kryer nga INSTAT-i.
- ☑ Të përcaktohen institucionet dhe mekanizmat për bashkërendimin e mbledhjes së të dhënave për ZRRF-në, ndryshimet klimatike dhe mjedisin.



DREJTËSIA

MASAT KUNDËR KORRUPSIONIT

SHËNDETËSIA

BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL

ZVOGËLIMI I RREZIKUT NGA FATKEQËSITË DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

DIGJITALIZIMI DHE TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

ADMINISTRATA PUBLIKE

VETËQEVERISJA VENDORE DHE ZHVILLIMI VENDOR

RINIA